



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera
Ministry of Finance, Labour and Transfers

INSPEKTORATI QENDROR I PUNËS

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2025

Publikuar në muajin shkurt 2026

Adresa: Rruga “Qamil Hoxha”, nr. 30, Prishtinë, Kosovë

Tel: 0800 77577

E-mail: inspektorati.punes@rks-gov.net



Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	3
Lista e tabelave dhe figurave	4
Parathënie	6
Përmbledhje	7
1. Hyrje	8
2. Korniza ligjore, organizimi dhe kompetencat.....	8
3. Punësimi, njësitë ekonomike totale dhe nën mbikëqyrje inspektuese	11
3.1. Punësimi dhe njësitë ekonomike	11
3.2. Mbulueshmëria e sigurimit social / shoqëror	13
3.3. Mbulueshmëria e inspektimit të punës.....	13
4. Burimet njerëzore	14
5. Buxheti dhe burimet financiare	19
6. Përmirësimi i infrastrukturës dhe kushteve të punës	21
6.1. Digjitalizimi	23
7. Aktivitetet inspektuese dhe statistikat	24
7.1. Veprimet inspektuese.....	24
7.2. Vizitat inspektuese.....	28
7.3. Ankesat apo raportet zyrtare.....	30
7.4. Efikasiteti i përdorimit të burimeve njerëzore të Inspektoratit	31
8. Marrëdhëniet e punës.....	31
9. Siguria dhe shëndeti në punë	34
9.1. Aksidentet në punë	34
9.2. Shkeljet dhe parregullësitë e evidentuar gjatë vizitave inspektuese	39
9.3. Vlerësimi i riskut.....	39
9.4. Manualët dhe listat e kontrollit për fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë	40
9.5. Sëmundjet profesionale.....	41
10. Grevat	41
11. Aktivitetet e ndryshme.....	42
12. Përfundime dhe rekomandime.....	59
12.1. Përfundimet	59
12.2. Rekomandimet	60
13. Referencat	61
14. Shtojca	62
14.1. Ligjet dhe rregulloret relevante për shërbimit të inspektimit	62



Lista e shkurtesave

Shkurtesa	Përshkrimi
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkim Evropian
CDF	Capacity Development Facility
ECMI	European Centre for Minority Issues – Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave
ECMS	Electronic Case Management System
EU-OSHA	Agjencia Evropiane e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH – Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
ICMPD	International Centre for Migration Policy Development – Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migracionit
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
IKS	Kosovo Stability Initiative (IKS) – Iniciativa Kosovare për Stabilitet
ILO	International Labour Organization – Organizata Ndërkombëtare e Punës
IQP	Inspektorati Qendror i Punës
KE	Komisioni Evropian
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MP	Marrëdhënie Pune
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
QPA	Qendra për Politika dhe Avokim
RCC	Regional Cooperation Council – Këshilli për Bashkëpunim Rajonal
SEMR	Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Rasteve
SSHP	Siguri dhe Shëndet në Punë
UNDP	United Nations Development Programme – Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
ZIP	Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZIP	Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm
ZKM	Zyra e Kryeministrit



Lista e tabelave dhe figurave

Tabela 1. Numri i përgjithshëm i personave të punësuar sipas regjionit	11
Tabela 2. Numri i përgjithshëm i personave të punësuar sipas sektorit institucional	11
Tabela 3. Numri i përgjithshëm i personave të punësuar sipas degës së aktivitetit ekonomik	12
Tabela 4. Statusi në punësim (personave/popullsisë të punësuar)	12
Tabela 5. Numri i njësive ekonomike sipas madhësisë së të punësuarve	13
Tabela 6. Struktura e inspektorëve sipas regjioneve	15
Tabela 7. Ndarje e inspektorëve në MP dhe SSHP	15
Tabela 8. Ndarja sipas hierarkisë	15
Tabela 9. Numri i stafit administrativ që mbështet inspektoratet, të ndarë sipas rajonit të vendit.	15
Tabela 10. Norma e inspektorëve të punës (për 100 000 të punësuar të mbuluar nga inspektimi i punës). ..	16
Tabela 11. Norma e inspektorëve të punës (për 100 000 popullsi të punësuar)	16
Tabela 12. Norma e inspektorëve të punës (për 100 000 të punësuar)	16
Tabela 13. Raportin mes numrit të njësive ekonomike që i nënshtrohen inspektimit dhe numrit të Inspektorëve	16
Tabela 14. Buxheti i Inspektoratit ndër vite	19
Tabela 15. Pjesa (%) e buxhetit të Inspektoratit në buxhetin e MFPT	19
Tabela 16. Pjesa (%) e buxhetit të Inspektoratit në buxhetin e Administratës Shtetërore	20
Tabela 17. Numri i zyrave të përdorura nga Inspektorati	21
Tabela 18. Numri i kompjuterëve funksional në dispozicion për Inspektoratin	21
Tabela 19. Numri i automjeteve transportuese funksionale në dispozicion për Inspektoratin	22
Tabela 20. Veprimet inspektuese të ndara në proaktive dhe reaktive	25
Tabela 21. Veprimet inspektuese proaktive dhe reaktive sipas regjionit	26
Tabela 22. Veprimet inspektuese reaktive sipas ankesës	30
Tabela 23. Numri i vizitave, inspektorëve dhe mesatarja e vizitave të kryera për inspektor të ndarë sipas rajonit	31
Tabela 24. Punëtorë të inspektuar krahasuar me punëtorë të pa regjistruar në ATK	32
Tabela 25. Punëtorë pa kontrata	32
Tabela 26. Diskriminimet e evidentuara	32
Tabela 27. Përmbledhje e shkeljeve të evidentuara në marrëdhëniet e punës	33
Tabela 28. Aksidentet & Lëndimet në punë sipas regjioni të ndara në fatale dhe jo fatale	35
Tabela 29. Aksidentet & Lëndimet në punë sipas veprimtarisë të ndara në fatale dhe jo fatale	36
Tabela 30. Aksidentet & Lëndimet me fatalitet sipas regjionit dhe gjinisë	37
Tabela 31. Shkeljet e evidentuara në SSHP	39
Tabela 32. Shkelje të evidentuara për dokumentin e vlerësimit të riskut	40
Tabela 33. Shkeljet e evidentuara në angazhimin e ekspertëve të SSHP-së nga punëdhënësit	40
Tabela 34. Shkeljet e evidentuara në kontrollet mjekësore të papërfunduar	41



Figura 1. Struktura organizative e Inspektoratit Qendror të Punës.....	10
Figura 2. Stafit i IQP-së, 2025	14
Figura 3. Struktura gjinore e inspektorëve	14
Figura 4. Ndarja e stafit të IQP në % sipas profesionit.....	17
Figura 5. Numri i inspektorëve dhe udhëheqësve të divizioneve për inspektime sipas profesionit	18
Figura 6. Norma e rritjes së buxhetit të Inspektoratit	19
Figura 7. Norma e rritjes së buxhetit të Inspektoratit në terma realë.....	20
Figura 8. Veprimet inspektuese ndër vite.....	24
Figura 9. Veprimet inspektuese sipas muajve, 2025	25
Figura 10. Veprimet inspektuese sipas sektorit në %.....	25
Figura 11. Veprimet inspektuese proaktive sipas regjionit dhe llojit	26
Figura 12. Veprimet inspektuese reaktive sipas regjionit dhe llojit	27
Figura 13. Gjithsej veprimet inspektuese sipas aktivitetit ekonomik	27
Figura 14. Punëtorë të inspektuar sipas muajve, 2025	28
Figura 15. Punëtorë të huaj të inspektuar	28
Figura 16. Raporti i vizitave proaktive ndaj vizitave reaktive.....	29
Figura 17. Shpërndarja e lëndëve nga vizitat inspektuese.....	29
Figura 18. Ankesat e paraqitura sipas gjinisë	30
Figura 19. Inspektime sipas ankesave ndër muaj	30
Figura 20. Numri mesatar i vizitave të kryera për inspektor të ndarë sipas rajonit	31
Figura 21. Punëtorë pa kontrata të ndara sipas gjinisë	32
Figura 22. Aksidentet në punë sipas muajve, 2025	35
Figura 23. Lëndimet në punë sipas muajve, 2025	35
Figura 24. Shkalla e aksidenteve & lëndimeve (sipas ndarjes) fatale në numrin e përgjithshëm të aksidenteve & lëndimeve fatale të raportuara.....	36
Figura 25. Shkalla e aksidenteve & lëndimeve (sipas ndarjes) jo fatale në numrin e përgjithshëm të aksidenteve & lëndimeve jo fatale të raportuara	37
Figura 26. Aksidentet & lëndimet në punë jo fatale sipas regjionit dhe gjinisë	38
Figura 27. Aksidentet & lëndimet në punë me pasoja fatale ndër vite	38



Parathënie

Raporti vjetor paraqet veprimtarinë mbikëqyrëse të Inspektoratit Qendror të Punës (IQP) për periudhën janar – dhjetor 2025. Dokumenti është hartuar në pajtim të plotë me kornizën ligjore në fuqi të Republikës së Kosovës. Ky raport shërben si mjeti kryesor i llogaridhënies për IQP-në, duke përmbledhur rezultatet kryesore të arritura, sfidat dhe masat e marra për përmirësim.

Të dhënat kryesore ofrojnë informata gjithëpërfshirëse për gjendjen e zbatimit të legjislacionit të punës në Kosovë gjatë vitit 2025, duke përfshirë: ligjet dhe rregulloret relevante për punën e shërbimit të inspektimit, stafin e shërbimit të inspektimit të punës, statistikave të vendeve të punës që i nënshtrohen inspektimit, numrin e punëtorëve të punësuar, vizitat inspektuese, shkeljet e evidentuara, aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale. Gjithashtu, raporti synon të identifikojë trendet e ndodhive, parregullsitë e ndryshme, dhe të rekomandojë masa për përmirësimin e sistemit inspektues.

Inspektorati Qendror i Punës shpreh mirënjohjen e tij të sinqertë ndaj Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) për mbështetjen teknike të ofruar në përgatitjen e Raportit Vjetor për vitin 2025. Bashkëpunimi me ILO-n ka qenë i vlefshëm për forcimin e strukturës dhe metodologjisë së përgjithshme të raportimit, si dhe për orientimin e përpjekjeve drejt harmonizimit të praktikave të raportimit me Udhëzuesin e ILO-së për Harmonizimin e Statistikave të Inspektimit të Punës.

Njëkohësisht, Inspektorati Qendror i Punës pranon se disponueshmëria, konsistenca dhe plotësia e të dhënave mbeten një sfidë. Për disa tregues nuk ka qenë i mundur raportimi i plotë për shkak të mungesave në të dhëna, kufizimeve të sistemeve ekzistuese të informacionit, si dhe kufizimeve kalimtare në proceset e mbledhjes dhe konsolidimit të të dhënave. Këto mangësi kanë ndikuar në thellësinë e analizës në disa fusha dhe nxjerrin në pah nevojën për forcim të mëtejshëm institucional.

Inspektorati Qendror i Punës mbetet i përkushtuar për adresimin gradual të këtyre boshllëqeve përmes përmirësimit të sistemeve të menaxhimit të të dhënave, forcimit të koordinimit të brendshëm dhe rritjes së kapaciteteve të stafit. Këto përpjekje synojnë të sigurojnë statistika më gjithëpërfshirëse, të besueshme dhe të harmonizuara të inspektimit të punës në ciklet e ardhshme të raportimit, duke mbështetur vendimmarrje më efektive, transparencë dhe përmirësim të respektimit të legjislacionit të punës.




Përmbledhje

Raporti vjetor i punës është përgatitur në përputhje me kornizën ligjore në fuqi të Republikës së Kosovës, si dhe duke u bazuar në udhëzimet nga:

- Konventa mbi Inspektimin e Punës, 1947, (Nr. 81).¹
- Konventa mbi Inspektimin e Punës (Bujqësi), 1969 (Nr. 129).²
- Udhëzuesi për Harmonizimin e Statistikave të Inspektimit të Punës - ILO.³

Analizat përgjatë këtij dokumenti ofrojnë detaje të gjetjeve kryesore statistikore për vitin 2025, shoqëruar me tabela dhe figura sqaruese, si dhe rekomandime për përmirësim. Ndërsa, paraqitja e statistikave në vijim, pasqyrojnë një përmbledhje të përgjithshme të faktorëve kryesorë lidhur me inspektimet e punës.⁴



Gjatë vitit 2025, Inspektorati Qendror i Punës ka bërë përparim si në aspektin operacional ashtu edhe në modernizimin institucional. Megjithatë, sfidat kryesore, veçanërisht në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, kërkojnë vëmendje të vazhdueshme dhe veprime të menjëhershme. Prioritetet e vitit 2026 do të fokusohen në adresimin e këtyre sfidave, me objektiva konkrete për reduktimin e aksidenteve, punën e pa dekluarar, rritjen e numrit të veprimeve dhe vizitave inspektuese, si dhe konsolidimin e mëtejshëm të kapaciteteve të Inspektoratit Qendror të Punës.

¹ C081 - Konventa mbi Inspektimin e Punës.

² C129 - Konventa mbi Inspektimin e Punës (Bujqësi).

³ Udhëzuesi i ILO-s për Harmonizimin e Statistikave të Inspektimit të Punës.

⁴ Të dhënat e IQP-së.



1. Hyrje

Inspektorati Qendror i Punës, funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. IQP-ja është i vetmi organ në kuadër të pushtetit ekzekutiv të Republikës së Kosovës që monitoron zbatimin e legjislacionit në fushën e marrëdhënieve të punës, si dhe të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Misioni i Inspektoratit është të sigurojë një mjedis pune të sigurt, të denjë dhe të ligjshëm për të gjithë punëtorët dhe punëdhënësit, përmes inspektimeve parandaluese dhe veprimeve detyruese, kur këto janë të nevojshme. Vizioni strategjik synon fuqizimin e rolit monitorues dhe mbikëqyrës të Inspektoratit, përmes qasjeve proaktive, parandalimit dhe reagimit të shpejtë ndaj rreziqeve dhe shkeljeve në vendin e punës.

Qëllimi i raportit vjetor 2025 është të paraqesë aktivitetet dhe arritjet e Inspektoratit Qendror të Punës gjatë vitit raportues, si dhe performancën institucionale, sfidat kryesore dhe prioritetet për të ardhmen. Metodologjia e përpunimit të të dhënave bazohet në të dhënat statistikore të përfshira në raport, kryesisht në regjistrimet zyrtare të Inspektoratit Qendror të Punës. Gjithashtu, përfshihen burime apo të dhëna plotësuese, si ato të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK).

2. Korniza ligjore, organizimi dhe kompetencat

Baza ligjore për themelimin dhe funksionimin e IQP-së është përcaktuar me:

- Ligjin Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë;
- Ligjin Nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës 2002/9;
- Rregulloren (ZKM) Nr. 10/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Ekzekutive të Inspektoratit Qendror të Punës.

IQP-ja udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv i Inspektoratit Qendror të Punës, i cili për punën e tij dhe të institucionit që udhëheq, raporton drejtpërdrejt te Ministri i MFPT-së. Inspektorati Qendror i Punës mbikëqyr zbatimin e:

- Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës;
- Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë;
- Ligjit Nr. 08/L-067 për Inspektimet.

Gjithashtu, mbikëqyr edhe zbatimin e disa dispozitave të ligjeve të tjera, si:

- Ligji Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit;
- Ligji Nr. 03/L-200 për Grevat;
- Ligji Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Ligji Nr. 04/L-219 për të Huajt;
- Ligji Nr. 04/L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë;
- Ligji Nr.02/L-81për Nxitjen dhe Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri
- Ligji Nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Njëkohësisht, mbikëqyr edhe zbatueshmërinë e akteve nënligjore që dalin nga këto ligje dhe që lidhen me marrëdhënien e punës, si dhe sigurinë dhe shëndetin në punë.



Gjatë vitit 2025 nuk ka pasur ndryshime ligjore apo rregullative në fushën e marrëdhënieve të punës, dialogut social, sigurisë dhe shëndetit në punë. Kuadri ligjor në fuqi ka mbetur i pandryshuar dhe është zbatuar në tërësinë e tij gjatë gjithë vitit raportues.⁵

Legjislacioni që rregullon punën e shërbimit të inspektimit të punës zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjitha industritë, përfshirë edhe sektorin e bujqësisë, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.⁶

Ligjet dhe rregulloret relevante për punën e shërbimit të inspektimit, janë të listuara dhe të paraqitura në Shtojcën e këtij dokumenti, me emërtimin përkatës.

Organizimi dhe kompetencat

IQP-ja funksionon si inspektorat qendror me kompetencë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Shtrirja rajonale e Inspektoratit është e organizuar në shtatë (7) rajone: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Ferizaj, Prizren, Gjiilan dhe Gjakovë. Duhet të theksohet se në tremujorin e fundit të vitit 2025, rajoni i Prishtinës është ndarë në dy divizione: Prishtina 1 (Prishtinë, Fushë Kosovë, Lipjan, Graçanicë) dhe Prishtina 2 (Podujevë, Obiliq, Drenas).

Secili prej rajoneve udhëhiqet nga një Udhëheqës i Divizionit për Inspektime, dhe të njëjtit koordinojnë punën e inspektorëve në terren dhe raportojnë drejtpërdrejt te Drejtori Ekzekutiv i IQP-së.

Inspektorët, si pjesë e Inspektoratit Qendror të Punës (IQP), ushtrojnë kompetencat e tyre inspektuese në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Ata janë të autorizuar ligjërisht të mbikëqyrin zbatimin e legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe ligje dhe akte të tjera specifike që bien në fushëveprimin e IQP-së.

Në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-067 për Inspektimet, IQP-ja ushtron kompetenca të plota inspektuese në nivel kombëtar, duke vepruar në mënyrë të pavarur dhe profesionale. Këto kompetenca përfshijnë mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit, marrjen e masave administrative dhe parandaluese, këshillimin e subjekteve të inspektimit, si dhe koordinimin me institucione të tjera.

⁵ Divizioni për Politikën e Marrëdhënieve në Punë dhe Dialogut Social & Divizioni për Politikën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, MFPT.

⁶ C081 – Konventa mbi Inspektimin e Punës, Neni 21, pika (a) & C081 – Konventa mbi Inspektimin e Punës (Bujqësi), Neni 27, pika (a).




Figura 1. Struktura organizative e Inspektoratit Qendror të Punës⁷

⁷ Rregulloren (ZKM) Nr. 10/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Ekzekutive të Inspektoratit Qendror të Punës, Shtojca Nr. 1, f. 25.



3. Punësimi, njësiti ekonomike totale dhe nën mbikëqyrje inspektuese

Të dhënat e paraqitura në këtë kapitull mbi punësimin dhe njësiti ekonomike totale, janë siguruar nga ATK⁸. Të dhënat e ATK-së janë përdorur si informacion i vetëm për vitin raportues. Këto të dhëna shërbejnë si bazë referuese për llogaritjen e treguesve statistikorë në përputhje me udhëzuesit e ILO-s dhe konventat përkatëse për inspektimin e punës, veçanërisht për analizën e njësive ekonomike të cilat janë brenda fushëveprimit të inspektimeve nga IQP-ja, numrit të personave të punësuar dhe shpërndarjes së tyre sipas karakteristikave kryesore. Po ashtu, ato përbëjnë bazën analitike për kapitujt në vijim, duke mundësuar ndërlidhjen e të dhënave të punësimit me aktivitetet inspektuese, vlerësimin e mbulimit inspektues dhe analizën e riskut sipas sektorëve ekonomikë.

Si rekomandim për vitin 2026, do të kërkohet që ndarja e të dhënave të bëhet në mënyrë më të detajuar, në përputhje me kërkesat e përcaktuara, përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me ATK-në dhe ASK-në. Aktualisht, të dhënat nuk janë të disponueshme në nivelin e detajimit apo ndarjes që kërkohet për përmbushjen e plotë të këtyre kërkesave, prandaj avancimi i strukturës dhe cilësisë së të dhënave mbetet prioritet për periudhat raportuese në vijim.

Konceptet kryesore të personave të punësuar, popullsisë së punësuar dhe të punësuarit, duke përfshirë përkufizimet, llogaritjet, etj., janë bazuar në Udhëzuesin për Harmonizimin e Statistikave të Inspektimit të Punës.⁹

3.1. Punësimi dhe njësiti ekonomike


Sipas të dhënave të siguruara nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), numri i përgjithshëm i personave të punësuar arrin në **455 184**, duke përfshirë të gjithë personat e regjistruar si të punësuar ose të vetëpunësuar, në përputhje me legjislacionin tatimor dhe atë të punës në fuqi.

Rajoni	Numri i personave
Prishtinë	297 795
Mitrovicë	24 185
Pejë	24 339
Prizren	37 014
Ferizaj	31 815
Gjilan	21 682
Gjakovë	18 354
Gjithsej	455 184

Tabela 1. Numri i përgjithshëm i personave të punësuar sipas regjionit

Sektori	Numri i personave
Publik	104 330
Privat	350 854
Gjithsej	455 184

Tabela 2. Numri i përgjithshëm i personave të punësuar sipas sektorit institucional



Të dhënat e tabelave 3 dhe 4, tregojnë se në total janë 455 184 persona të punësuar, ku pjesa më e madhe i përket sektorit privat me 350 854 punëtorë, ndërsa sektori publik përbën 104 330 persona të punësuar. Kjo tregon se rreth 77% e fuqisë punëtore është e angazhuar në sektorin privat, duke reflektuar një dominim të ekonomisë private në tregun e punës, ndërsa sektori publik përbën rreth 23% të të punësuarve.

⁸ Të gjitha të dhënat e paraqitura në këtë kapitull, janë siguruar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).

⁹ [Udhëzuesi](#) i ILO-s për Harmonizimin e Statistikave të Inspektimit të Punës.



Aktivitetet Ekonomike	Gjithsej	%
A – Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	3 577	0.8%
B - Industria nxjerrëse	3 272	0.7%
C - Industria përpunuese	42 130	9.3%
D - Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	4 430	1.0%
E - Furnizimi me ujë, kanalizimi, aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave	5 478	1.2%
F - Ndërtimtaria	27 868	6.1%
G - Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	88 958	19.5%
H - Transporti dhe magazinimi	9 138	2.0%
I - Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	23 535	5.2%
J - Informimi dhe komunikimi	18 200	4.0%
K - Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	16 278	3.6%
L - Aktivitetet e patundshmërisë	1 609	0.4%
M - Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	15 858	3.5%
N - Shërbimet administrative dhe mbështetëse	16 648	3.7%
O - Administrimi publik dhe mbrojtja, sigurimi social i detyrueshëm	103 829	22.8%
P - Arsimi	7 964	1.7%
Q - Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	10 478	2.3%
R - Artet, argëtimi dhe rekreacioni	2 597	0.6%
S - Aktivitetet e tjera shërbyese	16 098	3.5%
T - Person fizik	325	0.1%
U - Aktivitetet e trupave dhe organizatave ndërkombëtare	1 553	0.3%
Tjera	35 361	7.8%
Gjithsej	455 184	100%

Tabela 3. Numri i përgjithshëm i personave të punësuar sipas degës së aktivitetit ekonomik

Bazuar në të dhënat e paraqitura, administrimi publik dhe mbrojtja, sigurimi social i detyrueshëm (22.8%) përfaqëson sektorin me pjesëmarrjen më të lartë. Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve motorike (19.5%), i ndjekur nga industria përpunuese (9.3%). Ndërtimtaria (6.1%), akomodimi dhe shërbimi ushqimor (5.2%). Ndërsa, industritë e tjera kanë përfaqësojnë pjesëmarrje më të vogël.

Statusi në punësim	Numri i personave
Të punësuar	448 975
Të vetë punësuar	6 209
Gjithsej	455 184

Tabela 4. Statusi në punësim (personave/popullsisë të punësuar)

Të dhënat na tregojnë se numri i përgjithshëm i të punësuarve (nuk janë të përfshirë të vetëpunësuarit) është: **448 975**.



Madhësia (personat e punësuar)	Numri i njësive ekonomike
1-4	123 323
5-19	10 503
20-49	1 650
50-99	413
100-499	317
500+	43
Gjithsej	136 249

Tabela 5. Numri i njësive ekonomike sipas madhësisë së të punësuarve

Të dhënat në tabelë tregojnë se struktura e njësive ekonomike dominohet nga bizneset e vogla. Njësitë me 1–4 të punësuar përbëjnë 123 323 njësi. Një numër dukshëm më i vogël përfaqësohet nga njësitë me 5–19 të punësuar (10 503), ndërsa ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha janë me 1 650 njësi, në kategorinë 20–49 dhe 773 njësi në kategoritë mbi 50 të punësuar. Njësitë me 500+ të punësuar janë 43, që tregon se aktiviteti ekonomik mbështetet kryesisht në ndërmarrje të vogla.

3.2. Mbulueshmëria e sigurimit social / shoqëror

Mbulueshmëria e sigurimit social/shoqëror në Republikën e Kosovës nuk është e rregulluar përmes një sistemi të unifikuar dhe të integruar sipas standardeve. Aktualisht, disa skema janë të rregulluara në mënyrë të veçantë, përfshirë sigurimin pensional përmes Trustit Pensional të Kosovës, si dhe dispozita të caktuara që lidhen me kompensimin financiar në rast të paaftësisë së përkohshme për punë, apo kur punëdhënësi obligohet të paguajë punëtorët për shkak të lëndimit në punë për kohën e caktuar sipas legjislacionit të marrëdhënieve të punës.

3.3. Mbulueshmëria e inspektimit të punës

Ky nënkaptull paraqet mbulueshmërinë e inspektimit të punës nga IQP-ja, bazuar në fushëveprimin ligjor për marrëdhëniet e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë. Edhe pse disa institucione publike nuk përfshihen njëkohësisht në të dyja fushat e inspektimit, ato që mbulohen në të paktën njërin prej tyre, konsiderohen pjesë e fushëveprimit të IQP-së dhe përfshihen në vlerësimet statistikore lidhur me numrin e të punësuarve dhe njësive ekonomike. Vetëm një numër i kufizuar institucionesh mbetet jashtë fushëveprimit inspektues të IQP-së në tërësi.

Popullsia e punësuar që mbulohet nga inspektimi i punës (të punësuar dhe të vetëpunësuar, përveç atyre që nuk janë në fushëveprimin e IQP-së dhe rrjedhimisht janë larguar nga totali i popullsisë së punësuar), është **449 749** duke pasqyruar shtrirjen e përgjegjësisë dhe fushëveprimit të Inspektoratit. Ky numër reflekton një mbulim të gjerë të popullsisë aktive, duke nënkuptuar se pjesa më e madhe e punëmarrësve janë subjekt i mbikëqyrjes institucionale për respektimin e legjislacionit të punës, sigurisë dhe shëndetit në punë. Sipas të dhënave **443 540** të punësuar (që nënkupton se janë larguar të vetëpunësuarit dhe të punësuarit që nuk janë në fushëveprimin e IQP-së), përfshihen në fushën e veprimit të Inspektoratit. Ky numër pasqyron përmasat e forcës punëtore që i nënshtrohet vazhdimisht verifikimit institucional lidhur me respektimin e dispozitave ligjore, kushtet e punës dhe kërkesat për siguri dhe shëndet në vendin e punës.

Nga të dhënat e siguruar **136 244** njësi ekonomike i nënshtrohen inspektimit (janë larguar sektorët që nuk i nënshtrohen inspektimeve të punës që nënkuptohet që janë të rregulluara me legjislacion të veçantë dhe nuk janë pjesë e legjislacionit mbikëqyrës të IQP-së), që pasqyron gjerësinë e aktivitetit mbikëqyrës mbi bizneset që ushtrojnë veprimtari ekonomike. Ky numër tregon përmasat e sektorit formal që kërkon kontroll dhe vlerësim të vazhdueshëm për zbatimin e legjislacionit në fuqi, duke reflektuar gjithashtu ngarkesën dhe kompleksitetin e procesit të inspektimit.



4. Burimet njerëzore

Ky kapitull paraqet të dhëna statistikore mbi burimet njerëzore të Inspektoratit, duke përfshirë strukturën e stafit, numrin e inspektorëve, shpërndarjen sipas funksioneve dhe kapacitetet institucionale për zbatimin e mandatit inspektues. Inspektorati Qendror i Punës funksionon si një strukturë e integruar inspektuese, ku i njëjti staf i inspektorëve mbulon të gjithë sektorët ekonomikë¹⁰, përfshirë edhe bujqësinë¹¹. Të gjitha veprimet në bujqësi bëhen nga i njëjti shërbim inspektues, pa ndarje formale të veçantë të stafit, ndërsa kapacitetet profesionale sigurohen përmes organizimit të brendshëm dhe zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore.




Figura 2. Staf i IQP-së, 2025¹²

Në përputhje me Rregulloren (ZKM) Nr. 10/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Ekzekutive të Inspektoratit Qendror të Punës, numri i përgjithshëm i të punësuarve është i përcaktuar në 171 pozita. Ky numër përfshin strukturën e plotë organizative, duke përfshirë: inspektorët për marrëdhënie në punë, inspektorët për siguri dhe shëndet në punë, si dhe stafin mbështetës administrativ. Gjatë vitit 2025, është iniciuar procedura për rritjen e stafit, me synim zbatimin e plotë të strukturës dhe numrit të përgjithshëm të vendeve të punës të përcaktuara me Rregulloren Nr. 10/2024. Megjithatë, për shkak të aspekteve procedurale dhe administrative, kjo procedurë nuk ka përfunduar me sukses brenda vitit raportues. Si rrjedhojë, realizimi i objektivit për rritjen e stafit, planifikohet të bëhet gjatë vitit 2026, në përputhje me dispozitat e rregullores dhe legjislacionin në fuqi.

Regjioni	Gra	Burra
Prishtinë	6	12
Prishtinë	1	2
Mitrovicë	1	5
Pejë	1	5
Gjakovë	1	2
Prizren	0	5
Ferizaj	5	1
Gjilan	2	5
Gjithsej	17	37




Figura 3. Struktura gjinore e inspektorëve

Struktura gjinore e inspektorëve të punës tregon se 69% e inspektorëve janë burra, ndërsa 31% janë gra. Kjo shpërndarje pasqyron përbërjen aktuale gjinore të personelit inspektues sipas rajoneve dhe shërben si tregues statistikor për vlerësimin e balancës gjinore në kuadër të institucionit. Në pozitat udhëheqëse është

¹⁰ C081 – Konventa mbi Inspektimin e Punës, Neni 21, pika (b).

¹¹ C081 – Konventa mbi Inspektimin e Punës (Bujqësi), Neni 27, pika (b).

¹² Divizioni i Burimeve Njerëzore në IQP.



një përfaqësim më i lartë i kuotës gjinore, çka dëshmon për angazhimin institucional për barazi gjinore dhe përfshirje në nivelet vendimmarrëse.

Regjioni	Numri i inspektorëve
Prishtina 1	18
Prishtina 2	3
Mitrovicë	6
Pejë	6
Gjakovë	3
Prizren	5
Ferizaj	6
Gjilan	7
Gjithsej (vetëm inspektorët)	54

Tabela paraqet shpërndarjen e inspektorëve sipas rajoneve. Në total, struktura përfshin 54 inspektorë.

Tabela 6. Struktura e Inspektorëve sipas regjioneve

Ndarja	Numri i inspektorëve
Inspektorë MP	30
Inspektorë SSHP	24
Gjithsej	54

Tabela paraqet ndarjen e inspektorëve në Marrëdhënie Pune (MP) dhe në Siguri dhe Shëndet në Punë (SSHP), e realizuar gjatë vitit 2025.

Tabela 7. Ndarje e Inspektorëve në MP dhe SSHP

Ndarja sipas hierarkisë	Numri
Drejtor Ekzekutiv	1
Drejtor	2
Udhëheqës	14
Zyrtar	7
Inspektorë	54
Gjithsej	78

Numri më i madh është tek inspektorët me 54, duke reflektuar fokusin kryesor të inspektoratit në aktivitetet operative dhe monitoruese në terren.

Tabela 8. Ndarja sipas hierarkisë

Regjioni	Numri
Qendër	16
Prishtina 1 & Prishtina 2	2
Mitrovicë	1
Pejë	1
Gjakovë	1
Prizren	1
Ferizaj	1
Gjilan	1
Gjithsej	24

Tabela paraqet shpërndarjen e stafit administrativ. Përqendrimi më i madh i stafit administrativ është në Qendër me gjithsej 16 punonjës. Ndërkaq, rajonet kanë nga një punonjës administrativ secili, në pozita udhëheqëse të divizioneve rajonale. Në total, stafi administrativ që mbështet inspektoratet përbëhet nga 24 punonjës.

Tabela 9. Numri i stafit administrativ që mbështet inspektoratet, të ndarë sipas rajonit të vendit.

Norma e inspektorëve për:

- a) $100\,000 \text{ persona të punësuar që i nënshtrohen inspektimit të punës} : (\text{Numri i inspektorëve të punës} \div \text{Popullsia e punësuar (persona të punësuar)} \text{ e mbuluar nga inspektimi i punës}) \times 100\,000$



Persona të punësuar që i nënshtrohen inspektimit të punës	449 749
Numri i inspektorëve	54
Norma e inspektorëve të punës (për 100 000 të punësuar)	12

Tabela 10. Norma e inspektorëve të punës (për 100 000 të punësuar të mbuluar nga inspektimi i punës)

Nga gjithsej 449 749 të punësuar që i nënshtrohen inspektimit të punës, mbulimi realizohet nga 54 inspektorë të punës, me një koeficient prej 12 inspektorësh për 100 000 të punësuar.

b) 100 000 persona të punësuar: $(\text{Numri i inspektorëve të punës} \div \text{Popullsia e punësuar}) \times 100\,000$

Popullsia e punësuar	455 184
Numri i inspektorëve	54
Norma e inspektorëve	11.9

Tabela 11. Norma e inspektorëve të punës (për 100 000 popullsi të punësuar)

Sipas të dhënave, 455 184 persona të punësuar mbulohen nga 54 inspektorë të punës, që rezulton me një koeficient prej afërsisht 12 inspektorësh për 100 000 persona të punësuar.

c) 100 000 të punësuarit: $(\text{Numri i inspektorëve të punës} \div \text{Numri i përgjithshëm i të punësuarve}) \times 100\,000$

Numri i përgjithshëm i të punësuarve	448 975
Numri i inspektorëve	54
Norma e inspektorëve	12

Tabela 12. Norma e inspektorëve të punës (për 100 000 të punësuar)

Referojuni sqarimit në Kapitullin 3, lidhur me “Popullsia e punësuar e mbuluar nga inspektimi i punës”, “Popullsia e punësuar” dhe “të punësuarit”.

Numri i njësive ekonomike që i nënshtrohen inspektimit:

$(\text{Numri i njësive ekonomike që i nënshtrohen inspektimit} \div \text{Numri i inspektorëve të punës})$

Numri i njësive ekonomike që i nënshtrohen inspektimit	136 244
Numri i inspektorëve	54
Norma e inspektorëve	2 523

Tabela 13. Raporti mes numrit të njësive ekonomike që i nënshtrohen inspektimit dhe numrit të inspektorëve

Të dhënat e paraqitura mbi normën e inspektorëve të punës, të llogaritura për 100 000 persona të punësuar tregojnë që janë 12 inspektorë për 100 000 persona të punësuar. Pavarësisht dallimeve ndërmjet kategorive “popullsia e punësuar (persona të punësuar) e mbuluar nga inspektimi”, “popullsia e punësuar” dhe “numri i përgjithshëm i të punësuarve”, rezultatet mbeten pothuajse identike. Shprehur në terma relativë, norma prej rreth 12 inspektorësh për 100 000 persona të punësuar korrespondon me afërsisht 1.2 inspektorë për çdo 10 000 persona të punësuar. Ky përfaqësim përdoret për qëllime krahasuese dhe analitike, duke mundësuar një interpretim më të qartë të kapacitetit inspektues në raport me madhësinë e fuqisë punëtore, pa nevojë për llogaritje shtesë metodologjike. Megjithatë norma aktuale e inspektorëve për 100 000 persona të punësuar paraqet një nivel formalisht të krahasueshëm me praktikën rajonale, ajo nuk pasqyron plotësisht



ngarkesën reale dhe kompleksitetin e punës inspektuese. Përveç inspektimeve të planifikuara, inspektorët janë të angazhuar në një volum të konsiderueshëm aktiviteteve reaktive, përfshirë trajtimin e ankesave, hetimin e aksidenteve në punë dhe rastet emergjente, si dhe detyra të shumta administrative, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në kapacitetin efektiv të inspektimit.

Në përputhje me Rregulloren (ZKM) Nr. 10/2024, për vitin 2026, parashihet rritja e ndjeshme e kapacitetit inspektues, me 63 inspektorë të planifikuar për marrëdhëniet e punës dhe 57 inspektorë për sigurinë dhe shëndetin në punë. Kjo rritje krijon bazën për përmirësimin gradual të raportit inspektor–punëtor dhe për afrimin drejt objektivit funksional prej 1 deri në 2 inspektorë për çdo 10 000 persona të punësuar, në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të fushës përkatëse.

Paralelisht me rritjen e burimeve njerëzore, digjitalizimi i proceseve të inspektimit dhe avancimi i sistemeve të menaxhimit të rasteve, pritet të reduktojë barrën administrative të inspektorëve dhe të rrisë efikasitetin operacional. Këto masa do të krijojnë kushte më të favorshme për një fokus më të madh në inspektime të planifikuara dhe parandaluese në periudhën afatmesme.

Kualifikimi dhe trajnimet

Figurat në vijim paraqesin strukturën profesionale të stafit të Inspektoratit Qendror të Punës dhe shpërndarjen e inspektorëve dhe udhëheqësve sipas profesionit dhe rajonit, duke ofruar një pasqyrë të kapaciteteve ekzistuese njerëzore dhe mbulimit territorial të shërbimit inspektues. Këto të dhëna shërbejnë si bazë për vlerësimin e përshtatshmërisë së profileve profesionale, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe planifikimet e ardhshme, në përputhje me kornizën ligjore dhe organizative në fuqi.




Figura 4. Ndarja e stafit të IQP-së në % sipas profesionit

Struktura profesionale e stafit dominohet nga profili juridik, i cili përbën përqindjen më të lartë të stafit, duke reflektuar fokusin institucional në zbatimin e legjislacionit të punës dhe procedurave administrative. Përfaqësimi i profesioneve teknike dhe shkencore është më i kufizuar, por i pranishëm në funksion të mbulimit të fushave specifike të inspektimit. Kjo strukturë pasqyron nevojat aktuale operationale, por njëkohësisht evidenton hapësirë për balancim të mëtejshëm të profileve profesionale, veçanërisht në sektorët me risk të lartë.



Figura 5. Numri i inspektorëve dhe udhëheqësve të divizioneve për inspektime sipas profesionit

Zhvillimet profesionale dhe trajnimet

Të gjitha aktivitetet e trajnimit, punëtoritë, fushatat ndërgjegjësuere, monitorimet në terren dhe pjesëmarrjet ndërkombëtare të realizuara gjatë vitit 2025 janë zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, përfshirë organizata ndërkombëtare, institucione shtetërore, organizata të shoqërisë civile dhe partnerë zhvillimorë, sipas projekteve dhe donatorëve përkatës të cekur në raport.

Përmbledhje sipas llojit të aktivitetit:

1. Trajnime profesionale

- Janë realizuar 6 trajnime profesionale për stafin inspektues dhe pozita tjera relevante.
- Tematika kryesore: siguria dhe shëndeti në punë, investigimi i aksidenteve dhe vdekjeve në vendin e punës, diskriminimi në vendin e punës dhe mbikëqyrja e punësimit të punëtorëve migrantë.

2. Punëtori dhe sesione tematike

- Janë ndjekur 6 punëtori tematike, përfshirë rishikimin e dokumenteve udhëzuese, të drejtat e punës, migrimin për punë dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.
- Punëtoritë janë zhvilluar në nivel kombëtar dhe rajonal.

3. Konferenca dhe pjesëmarrje ndërkombëtare

- 2 aktivitete ndërkombëtare me përfaqësim institucional (Tiranë dhe Vjenë).
- Fokus në politikat sociale, të drejtat e punës dhe migracionin për punë.

IQP-ja ka zhvilluar bashkëpunim aktiv me partnerë, si: ILO, GIZ, ECMI, RCC, UNDP, ICMPD, IKS, QPA dhe të tjerë.

Referencë në raport: Përshkrimi i detajuar i secilit aktivitet, përfshirë datat, titujt, projektet, zbatuesit, donatorët dhe numrin e pjesëmarrësve, është paraqitur në kapitullin “Aktivitetet e ndryshme”.



5. Buxheti dhe burimet financiare

Inspektorati Qendror i Punës financohet nga buxheti i konsoliduar i shtetit, nëpërmjet linjës buxhetore nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Viti	Buxheti
2020	823,078.00 €
2021	795,126.00 €
2022	790,632.00 €
2023	1,575,632.00 €
2024	1,355,862.00 €
2025	1,643,441.00 €

Tabela 14. Buxheti i Inspektoratit ndër vite¹³




Figura 6. Norma e rritjes së buxhetit të Inspektoratit

Tabela paraqet zhvillimin e buxhetit të inspektoratit për periudhën 2020–2025. Gjatë viteve 2020–2022 ka pasur rënie të buxhetit, nga 823,078.00 € në 790,632.00 €, me norma negative prej –3% dhe –1%. Kjo periudhë karakterizohet me stabilitet relativ, por me tendencë të uljes.

Në vitin 2023 shënohet një rritje e buxhetit, prej 99%, duke arritur në 1,575,632.00 €, që përfaqëson një ndryshim të rëndësishëm në nivelin e financimit. Pastaj një rënie prej –14% në vitin 2024, buxheti rritet sërish në vitin 2025 me 21%, duke arritur në 1,643,441.00 €. Në përgjithësi, ka pasur luhatje të financimit ndër vite, por me një nivel dukshëm më të lartë të buxhetit në vitet e fundit krahasuar me periudhën 2020–2022.

Viti	Buxheti i MFPT ¹⁴	Buxheti i Inspektoratit	Pjesa (%) në buxhetin e MFPT
2022	1,019,101,596.00 €	790,632.00 €	0.08%
2023	1,055,370,611.00 €	1,575,632.00 €	0.15%
2024	906,753,963.00 €	1,355,862.00 €	0.15%
2025	1,019,101,596.00 €	1,643,441.00 €	0.16%

Tabela 15. Pjesa (%) e buxhetit të Inspektoratit në buxhetin e MFPT-së

Tabela paraqet pjesën e buxhetit të Inspektoratit të Punës në raport me buxhetin total të MFPT-së, për periudhën 2022–2025. Në vitin 2022, buxheti i Inspektoratit përbënte 0.08% të buxhetit të Ministrisë. Në vitin 2023 vërehet një rritje në 0.15%, si rezultat i rritjes së konsiderueshme të buxhetit të Inspektoratit, ndërsa në vitin 2024 kjo përqindje mbetet e njëjtë. Në vitin 2025, pjesa e buxhetit të Inspektoratit në buxhetin e Ministrisë rritet në 0.16%, duke shënuar nivelin më të lartë që nga viti 2022. Në tërësi, të dhënat tregojnë një trend gradual rritës të peshës së buxhetit të Inspektoratit brenda buxhetit të Ministrisë.

¹³ Divizioni për Buxhet dhe Financa në IQP.

¹⁴ Ligji Nr. 08/1-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, faqe 34, kodi 201.



Viti	Buxheti i Nivelit Qendror* ¹⁵	Buxheti i Inspektoratit	Pjesa (%) në buxhetin e Nivelit Qendror
2022	2,002,099,943.00 €	790,632.00 €	0.039%
2023	2,364,007,143.00 €	1,575,632.00 €	0.067%
2024	2,426,857,473.00 €	1,355,862.00 €	0.056%
2025	2,666,735,514.00 €	1,643,441.00 €	0.062%

Tabela 16. Pjesa (%) e buxhetit të Inspektoratit në buxhetin e Administratës Shtetërore

*Në mungesë të një ndarjeje të veçantë buxhetore për 'Administratën Shtetërore' sipas Udhëzuesit të ILO-s është përdorur Buxheti i Nivelit Qendror, duke qenë se ai përfshin institucionet kryesore ekzekutive të shtetit.




Figura 7. Norma e rritjes së buxhetit të Inspektoratit në terma realë¹⁶

¹⁵ Ligji Nr. 08/1-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, faqe 29.

¹⁶ ILO Udhëzuesi për Harmonizimin e Statistikave të Inspektimit të Punës, pika 2.4.1., Burimet financiare, Norma e rritjes së buxhetit të Inspektoratit të Punës.



6. Përmirësimi i infrastrukturës dhe kushteve të punës

Gjatë vitit 2025, Inspektorati Qendror i Punës ka bërë përmirësime në infrastrukturën dhe kushtet e punës, me qëllim që të rritet efikasiteti institucional dhe të përmbushen standardet ligjore në fuqi.

Janë realizuar renovime të zyrave rajonale, në: Ferizaj, Prishtinë, Prizren, Mitrovicë dhe Fushë Kosovë. Gjithashtu, për herë të parë është realizuar renovimi dhe funksionalizimi i Arkivit Qendror të IQP-së. Në vitin 2025, është bërë pajisja e inspektorëve për inspektime në terren, ku inspektorët janë pajisur me pajisje personale mbrojtëse. Kjo masë ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë së inspektorëve dhe profesionalizmin gjatë ushtrimit të detyrave në terren.

Rajoni	Numri i objekteve	Numri i zyrave	Qasja në internet
Qendër	2	13	Të gjitha
Prishtina 1	2	8	
Prishtina 2	3	5	
Mitrovicë	2	6	
Pejë	1	5	
Gjakovë	1	4	
Prizren	1	9	
Ferizaj	1	9	
Gjilan	3	6	
Gjithsej	16	65	

Tabela 17. Numri i zyrave të përdorura nga Inspektorati

Të dhënat paraqesin shpërndarjen e zyrave të përdorura nga Inspektorati sipas rajoneve. Nevojat për përmirësimin e disa zyrave apo kushteve shtesë të objekteve, do të trajtohen në raporte të veçanta.

Norma: (Numri i zyrave të përdorura nga Inspektorati i Punës me qasje në internet ÷ Numri i zyrave të përdorura nga Inspektorati i Punës) x 100 = 100%

Të gjitha këto zyra janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme teknologjike, pasi secila prej tyre ka qasje në internet.

Rajoni	Numri i kompjuterëve	
Qendër	16	Të gjithë kompjuterët kanë qasje në internet. Gjithashtu, inspektorët janë të pajisur me tableta, të cilat shërbejnë si mjete shtesë për kryerjen e detyrave të tyre. Nevojat për gjendjen e kompjuterëve, për ndërrimin e tyre apo kërkesa tjera të ngjashme, trajtohen në raporte të veçanta.
Prishtina 1	18	
Prishtina 2	4	
Mitrovicë	8	
Pejë	7	
Gjakovë	4	
Prizren	6	
Ferizaj	7	
Gjilan	8	
Gjithsej	78	

Tabela 18. Numri i kompjuterëve funksional në dispozicion për Inspektoratin

Norma: (Numri i kompjuterëve funksional në dispozicion të Inspektoratit të Punës ÷ Numri i inspektorëve të punës) = 100%.



Rajoni	Numri i automjeteve transportuese	Inspektorë	Norma për inspektorët
Prishtinë	11	21	0.52
Mitrovicë	2	6	0.33
Pejë	2	6	0.33
Gjakovë	2	3	0.67
Prizren	3	5	0.60
Ferizaj	2	6	0.33
Gjilan	3	7	0.43
Gjithsej	25	54	0.46

Tabela 19. Numri i automjeteve transportuese funksionale në dispozicion për Inspektoratin

Norma: (Numri i automjeteve transportuese funksionale në dispozicion të Inspektoratit të Punës/ Numri i inspektorëve të punës) = 46%.

Për sa i përket kapaciteteve logjistike, Inspektorati operon me një numër prej 25 automjeteve transportuese funksionale për të gjithë stafin e tij në terren. Duke marrë parasysh se numri total i inspektorëve është 54, kjo shifër rezulton në një shkallë të mbulueshmërisë prej 46% me mjete udhëtimi. Ky raport tregon se mjetet ekzistuese nuk mbulojnë nevojat individuale të çdo inspektori, duke kërkuar koordinim të përbashkët për realizimin e vizitave inspektuese.



6.1. Digjitalizimi



Digjitalizimi i Arkivit Qendror

Në vitin 2025 ka filluar procesi i digjitalizimit të Arkivit Qendror, përmes sistemit SMAED. Ky hap paraqet një avancim të rëndësishëm në ruajtjen e dokumentacionit, rritjen e sigurisë së të dhënave dhe lehtësimin e qasjes institucionale në dokumente.

Digjitalizimi i inspektimeve

Inspektorati Qendror i Punës ka ndërmarrë një hap thelbësor drejt modernizimit institucional, përmes lansimit të Sistemit Digjital të Inspektimeve të Punës, konkretisht përmes Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Rasteve (SEMR). Ky transformim synon rritjen e efikasitetit, transparencës, saktësisë dhe llogaridhënies në çdo fazë të inspektimeve, si dhe përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve.

Sistemi është zhvilluar dhe implementuar nga Inspektorati Qendror i Punës, me mbështetje teknike nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe financim nga Qeveria e Suedisë, si pjesë e projektit “Efikasiteti i Inspektoratit të Punës”. Në kuadër të këtij procesi, është realizuar zhvillimi teknik dhe funksional i sistemit, si dhe janë shpërndarë tableta dhe printerë për të gjithë inspektorët e punës në Kosovë, duke mundësuar zhvillimin dhe raportimin e inspektimeve në mënyrë digjitale dhe në kohë reale. Ky sistem është i ndërlidhur funksionalisht me proceset e brendshme të IQP-së dhe krijon bazë të strukturuar të të dhënave inspektuese, e cila lehtëson analizën, orientimin e inspektimeve bazuar në risk, raportimin institucional dhe bashkëpunimin me institucione të tjera relevante. Digjitalizimi i inspektimeve dhe menaxhimit të rasteve përfaqëson një reformë të qëndrueshme, që vendos themelet për zhvillim të mëtejshëm të shërbimeve digjitale dhe forcim të kapaciteteve institucionale të Inspektoratit Qendror të Punës.





7. Aktivitetet inspektuese dhe statistikat

Ky kapitull paraqet një analizë të detajuar të aktivitetit inspektues të Inspektoratit gjatë vitit 2025, me fokus te volumi i inspektimeve të realizuara, llojet e tyre, shpërndarja në sektorë dhe gjetjet kryesore.

Inspektimi i punës në sektorin e bujqësisë, paraqet sfida në aspektin e mbulimit statistikor dhe identifikimit të vendeve të punës, për shkak të natyrës sezonale dhe informale të punës.

7.1. Veprimet inspektuese

Veprimet inspektuese të Inspektoratit Qendror të Punës realizohen përmes qasjes proaktive dhe reaktive, në varësi të burimit të inicimit dhe qëllimit të ndërhyrjes.

Veprimet inspektuese proaktive përfshijnë inspektimet e planifikuara dhe të orientuara në parandalim, të cilat zhvillohen mbi bazën e planit vjetor dhe prioritetëve institucionale. Në këtë kategori përfshihen inspektimet e planifikuara, riinspektimet për verifikimin e zbatimit të masave, inspektimet e përbashkëta të realizuara në koordinim me institucionet e tjera kompetente, si dhe fushatat e ndryshme. Këto veprime synojnë identifikimin dhe adresimin e rreziqeve përpara se të ndodhin pasoja për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve.

Veprimet inspektuese reaktive ndërmerren si përgjigje ndaj ngjarjeve ose sinjalizimeve konkrete që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme. Në këtë kategori përfshihen inspektimet e paplanifikuara, inspektimet e aksidenteve, si dhe inspektimet e realizuara sipas ankesave nga sektori publik, privat apo publiko-privat. Këto veprime kanë karakter reagues dhe synojnë adresimin e shkeljeve dhe rreziqeve të konstatuara pas ndodhjes së një rasti konkret.

Përmes kombinimit të këtyre dy qasjeve, Inspektorati Qendror i Punës siguron mbikëqyrje efektive të zbatimit të legjislationit të punës dhe të sigurisë dhe shëndetit në punë, duke balancuar parandalimin me reagimin institucional ndaj rasteve urgjente.




Figura 8. Veprimet inspektuese ndër vite

Të dhënat sipas viteve tregojnë një rritje të qëndrueshme të veprimeve inspektuese nga viti 2022 deri në 2024, ku numri është rritur nga 6 316 në 12 011, duke reflektuar intensifikim gradual të aktivitetit inspektues. Në vitin 2025 vërehet një ulje e lehtë në 10 812 veprime, megjithatë niveli mbetet dukshëm më i lartë krahasuar me vitet 2022 dhe 2023. Në tërësi, trendi tregon zgjerim të kapacitetit dhe të fushëveprimit të inspektimeve.




Figura 9. Veprimet inspektuese sipas muajve, 2025

Të dhënat mujore tregojnë se veprimet inspektuese janë shpërndarë relativisht në mënyrë të qëndrueshme gjatë vitit, me një intensitet më të ulët në periudhën verore, veçanërisht në qershor (688) dhe maj (785). Nga korriku e tutje vërehet një rritje graduale, në shtator (1 064), ndërsa në tetor (1 025), nëntor (1 047) dhe dhjetor (1 005). Muajt e parë të vitit paraqesin vlera mesatare relativisht të qëndrueshme.




Figura 10. Veprimet inspektuese sipas sektorit në %

Nga të gjitha veprimet inspektuese 93% janë realizuar në institucionet private, ndërsa sektori publik përfshin 7% të totalit. Kjo shpërndarje reflekton një fokus të theksuar të aktivitetit inspektues në sektorin privat, krahasuar me sektorin publik.

Lloji i inspektimit	Veprime inspektuese	Shpërndarja
Proaktiv	7 945	73%
Reaktiv	2 867	27%
Total	10 812	100%

Tabela 20. Veprimet inspektuese të ndara në proaktive dhe reaktive



Të dhënat mbi veprimet inspektuese tregojnë se pjesa më e madhe e inspektimeve janë realizuar në mënyrë proaktive, me gjithsej 7 945 raste që përbëjnë shumicën e totalit prej 10 812 veprimesh inspektuese. Ndërkohë, inspektimet reaktive arrijnë në 2 867 raste duke reflektuar ndërhyrjet e kryera si reagim ndaj ankesave, aksidenteve apo nevojave specifike. Kjo strukturë tregon një orientim më të theksuar drejt parandalimit dhe kontrollit të planifikuar, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e burimeve mbetet e dedikuar edhe për trajtimin e rasteve të paraqitura gjatë vitit.

Regjioni	Proaktiv	Reaktiv
Ferizaj	1 141	221
Gjakovë	400	189
Gjilan	1 188	160
Mitrovicë	936	162
Pejë	880	279
Prishtinë	2 467	1 581
Prizren	933	275
Gjithsej	7 945	2 867

Tabela 21. Veprimet inspektuese proaktive dhe reaktive sipas regjionit




Figura 11. Veprimet inspektuese proaktive sipas regjionit dhe llojit

Të dhënat mbi veprimet inspektuese proaktive sipas regjionit dhe llojit, tregojnë se inspektimi i planifikuar dhe riinspektimet, përbëjnë kategorinë dominuese në të gjitha regjionet, me gjithsej 7226 raste, duke reflektuar fokus të theksuar në ndjekjen e zbatimit të masave parandaluese. Inspektimet e përbashkëta (468) dhe fushatat (251), kanë një peshë më të kufizuar në strukturën e përgjithshme.




Figura 12. Veprimet inspektuese reaktive sipas regjionit dhe llojit

Tabela e veprimeve inspektuese reaktive, pasqyron aktivitetet e inspektoratit si përgjigje ndaj situatave të paplanifikuara, aksidenteve dhe ankesave në shtatë regjione të ndryshme, me një total prej 2 867 rasteve. Nga të dhënat vërehet se numri më i lartë i veprimeve reaktive është regjistruar në regjionin e Prishtinës me 1 581 raste.




Figura 13. Gjithsej veprimet inspektuese sipas aktivitetit ekonomik

Të dhënat sipas degëve tregojnë se sektori i tregtisë përbën pjesën më të madhe të veprimeve inspektuese me 25%. ndërtimtaria me 23%, shërbimet 22%, prodhimi 11%, ndërsa hoteleria 9%. Kategoria “Tjera” me 10%, tregon praninë e shëndetësisë, bujqësisë, energjetikës, minierave, arsimit, zejtarisë dhe të tjerave.




Figura 14. Punëtorë të inspektuar sipas muajve, 2025

Tabela tregon numrin total të punëtorëve të inspektuar sipas gjinisë. Nga gjithsej 44 029 punëtorë të inspektuar, 26 051 janë burra (rreth 59%) dhe 17 978 janë gra (rreth 41%).




Figura 15. Punëtorë të huaj të inspektuar

Tabela tregon numrin e punëtorëve të huaj të inspektuar sipas gjinisë, nga gjithsej 573 punëtorë të huaj të inspektuar, 426 janë gra (rreth 74%) dhe 147 janë burra (rreth 26%).

Gjithsej punëtorë të inspektuar **44 602** (Punëtorë: të inspektuar sipas muajve & të huaj).

7.2. Vizitat inspektuese

Bazuar në udhëzuesin e ILO-së, veprimet inspektuese dhe vizitat inspektuese në praktikë përkojnë, pasi veprimet inspektuese realizohen kryesisht përmes vizitave në terren. Për këtë arsye, gjatë vitit raportues, numri i veprimeve inspektuese është i barabartë me numrin e vizitave inspektuese. Përjashtim nga kjo përbëjnë fushatat ndërgjegjësuere/inspektuese në sektorin e ndërtimitarisë, gjatë së cilave janë realizuar 251 vizita në punishte të ndryshme, si aktivitet i veçantë dhe i strukturuar, i raportuar si veprim inspektues proaktiv. Këto fushata janë zhvilluar me mbështetjen teknike të ILO-s. Po ashtu, janë realizuara edhe disa fushata tjera në bashkëpunim me organizata të ndryshme joqeveritare, të cilat janë të paraqitura dhe të shtjelluara në një kapitull të veçantë, më poshtë në këtë dokument.

Ndarjet e tjera të paraqitura në raport (si inspektime të planifikuara, riinspektime, inspektime të paplanifikuara, inspektime pas aksidenteve dhe sipas ankesave) nuk paraqesin veprime shtesë, por klasifikime të ndryshme të të njëjtave vizita inspektuese, në përputhje udhëzuesin e ILO-s dhe praktikrat raportuese të Inspektoratit Qendror të Punës.

Sqarim: për të dhënat e paraqitura më poshtë, referojuni të dhënave proaktive dhe reaktive të veprimeve inspektuese më lartë.




Figura 16. Raporti i vizitave proaktive ndaj vizitave reaktive

Raporti i vizitave proaktive ndaj vizitave reaktive: $(\text{Vizitat proaktive të inspektimit} \div \text{Vizitat reaktive të inspektimit})$. Konkretisht të dhënat e shfrytëzuara janë marrë nga Tabela: Veprimet inspektuese proaktive dhe reaktive sipas regjionit.

Të dhënat mbi raportin e vizitave proaktive ndaj atyre reaktive, tregojnë dallime të theksuara ndërmjet regjioneve. Gjilani (7) dhe Mitrovica (6) shënojnë raportet më të larta, duke reflektuar një orientim më të fortë drejt vizitave të planifikuara dhe parandaluese. Ferizaj (5), gjithashtu, paraqet një raport relativisht të lartë, ndërsa Peja dhe Prizreni me nga (3) tregojnë një balancë më të moderuar ndërmjet dy llojeve të vizitave. Në Gjakovë dhe Prishtinë, raporti (2) sugjeron një peshë relativisht më të madhe të vizitave reaktive krahasuar me regjionet e tjera. Në nivel të përgjithshëm, raporti 3:1 tregon se vizitat proaktive dominojnë ndaj atyre reaktive, duke reflektuar një qasje të orientuar më shumë drejt parandalimit sesa reagimit.




Figura 17. Shpërndarja e lëndëve nga vizitat inspektuese

Nga gjithsej **1 747 gjoba të shqiptuara**, shuma totale e gjobave të shqiptuara në vlerë monetare arrin në **2,785,800.00 euro**, vlerë kjo që pasqyron ndikimin financiar të shkeljeve të konstatuara dhe zbatimin e masave administrative në kuadër të veprimtarisë inspektuese, duke shërbyer jo vetëm si masë ndëshkuese, por edhe si instrument korrektues dhe parandalues, për përmirësimin e përputhshmërisë me legjislacionin e punës dhe të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Ndërsa, figura më lart paraqet shpërndarjen e lëndëve që rrjedhin nga vizitat inspektuese, duke reflektuar se nga një veprim inspektues mund të rezultojnë një ose më shumë masa administrative dhe rrjedhimisht, më shumë se një lëndë, prandaj shpërndarja e lëndëve nuk barazohet domosdoshmërisht me numrin e vizitave inspektuese. Nga vizitat inspektuese zakonisht përgatitet raport zyrtar inspektimi, në të cilin evidentohen të gjitha parregullsitë e konstatuara në fushën e marrëdhënieve të punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, ku nga i njëjti raport dhe nga lëndët e krijuara mund të rrjedhin disa vërejtje dhe rekomandime për përmirësim në fusha specifike të marrëdhënies së punës dhe të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe masa të tjera administrative, përfshirë gjoba, pezullime të punimeve apo lejime për vazhdimin e punimeve. Në figurë janë paraqitur disa, por jo të gjitha, kategori të shpërndarjes së lëndëve, përfshirë edhe rastet e jo



kompetencës, e cila nënkupton mungesën e kompetencës ligjore të organit inspektues për trajtimin e një rasti si objekt inspektimi. Po ashtu, disa vendime për pezullim kanë vazhduar edhe në vitin 2026, çka bën që numri i lejitimeve për vazhdimin e punimeve të mos përkohë domosdoshmërisht me numrin e pezullimeve në vitin raportues.


7.3. Ankesat apo raportet zyrtare

Inspektorati Qendror i Punës ka paraqitur të dhënat lidhur me ankesat dhe raportet zyrtare sipas disa ndarjeve. Gjatë vitit raportues, të dhënat paraqesin numrin e përgjithshëm të ankesave dhe raporteve të pranuar dhe të trajtuara.

Sektori	Numri i ankesave
Publik	418
Privat	1 233
Publiko-privat	9
Gjithsej	1 660

Tabela 22. Veprimet inspektuese reaktive sipas ankesës

Nga gjithsej 1 660 inspektime të realizuara, vërehet një dominim i theksuar i ankesave në sektorin privat, i cili numëron 1 233 raste, ose rreth 74% të volumit total të punës inspektuese. Sektori publik renditet i dyti me 418 inspektime, ndërsa publiko-private përfaqësojnë një pjesë mjaft të vogël me vetëm 9 raste. Të gjitha ankesat e pranuar gjatë periudhës raportuese janë trajtuar, duke rezultuar në një normë trajtimi prej 100%, që dëshmon për funksionimin efektiv të mekanizmave të pranimit dhe reagimit ndaj ankesave dhe kontribuon në rritjen e besimit të publikut në punën e Inspektoratit.



Ankesat dominohen nga regjioni i Prishtinës, i cili përfaqëson 86% të totalit, ndërsa në nivel regjional nuk evidentohen dallime të theksuara gjinore në shpërndarjen e ankesave.

Figura 18. Ankesat e paraqitura sipas gjinisë




Figura 19. Inspektime sipas ankesave ndër muaj

Shpërndarja mujore e inspektimeve të realizuara sipas ankesave tregon luhatje të dukshme gjatë vitit.



7.4. Efikasiteti i përdorimit të burimeve njerëzore të Inspektoratit

Regjioni	Numri i vizitave	Inspektorë	Mesatarja e vizitave
Ferizaj	1 362	6	227
Gjakovë	589	3	196
Gjilan	1 348	7	193
Mitrovicë	1 098	6	183
Pejë	1 159	6	193
Prishtinë	4 048	21	193
Prizren	1 208	5	242
Gjithsej	10 812	54	200

Tabela 23. Numri i vizitave, inspektorëve dhe mesatarja e vizitave të kryera për inspektor, të ndarë sipas rajonit




Figura 20. Numri mesatar i vizitave të kryera për inspektor, të ndarë sipas rajonit

Tabela paraqet numrin mesatar të vizitave të kryera për inspektor, sipas rajonit dhe tregon dallime të moderuara në ngarkesën e punës ndërmjet rajoneve. Mesatarja e përgjithshme është 200 vizita për inspektor. Në tërësi, të dhënat sugjerojnë një shpërndarje relativisht të balancuar të vizitave, me disa dallime rajonale që reflektojnë ndryshime në intensitetin e punës.

8. Marrëdhëniet e punës

Marrëdhënia e punës është një nga fushat kryesore të mbikëqyrjes së Inspektoratit Qendror të Punës, pasi lidhet drejtpërdrejt me regjistrimin e punëtorëve, ekzistencën e kontratave të punës dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga punëdhënësit. Në këtë drejtim, Inspektorati bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), përmes shkëmbimit dhe krahasimit të të dhënave, me qëllim identifikimin e punëtorëve të paregjistruar dhe parandalimin e punës joformale.

Pavarësisht këtij bashkëpunimi, puna joformale vazhdon të mbetet një sfidë në disa sektorë dhe rajone, veçanërisht në zonat me aktivitet më të lartë ekonomik. Gjithashtu, vëmendje e veçantë kërkohet për punëtorët migrantë dhe kategori të tjera të cënueshme, të cilat mund të jenë më të ekspozuara ndaj shkeljeve të marrëdhënies së punës. Për këto arsye, formalizimi i marrëdhënieve të punës dhe forcimi i bashkëpunimit me ATK-në, do të jenë prioritet të rëndësishme për Inspektoratin Qendror të Punës në vitin e ardhshëm, me qëllim përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve dhe reduktimin e informalitetit në tregun e punës.



Regjioni	Punëtorë të inspektuar	Të paregjistruar në ATK
Ferizaj	4 140	64
Gjakovë	2 595	13
Gjilan	5 690	13
Mitrovicë	6 608	2
Peja	2 064	14
Prishtina	16 863	761
Prizren	6 642	48
Gjithsej	44 602	915

Tabela 24. Punëtorë të inspektuar krahasuar me punëtorë të paregjistruar në ATK

Tabela paraqet krahasimin ndërmjet numrit të punëtorëve të inspektuar dhe atyre të paregjistruar në ATK, sipas regjioneve dhe tregon dallime të theksuara. Nga gjithsej 44 602 punëtorë të inspektuar, 915 rezultojnë të paregjistruar në ATK, që përbën rreth 2.1% të totalit. Regjioni i Prishtinës ka numrin më të lartë të punëtorëve të inspektuar (16 863), ashtu edhe të atyre të paregjistruar (761).

Regjioni	Burra	Gra	Gjithsej
Ferizaj	50	41	91
Gjakovë	35	20	55
Gjilan	4	5	9
Mitrovicë	10	2	12
Pejë	31	2	33
Prishtinë	621	708	1 329
Prizren	350	67	417
Gjithsej	1 101	845	1 946

Tabela 25. Punëtorë pa kontrata




Figura 21. Punëtorë pa kontrata të ndara sipas gjinisë

Nga gjithsej 1 946 punëtorë pa kontrata, 57% janë burra dhe 43% gra. Prishtina përbën pjesën më të madhe të rasteve, me 621 burra dhe 708 gra. Në përgjithësi, të dhënat sugjerojnë se puna pa kontrata është më e theksuar në zonat me aktivitet më të madh ekonomik.

Lloji	Numri i diskriminimeve
Gjinor	3
Persona me aftësi të kufizuara	1
Mosha	3
Ndaj lehonave	10
Gjithsej	17

Tabela 26. Diskriminimet e evidentuara

Tabela paraqet rastet e diskriminimit të evidentuara sipas llojit dhe tregon se numri i tyre është relativisht i ulët. Nga gjithsej 17 raste të identifikuara, shumica lidhen me diskriminimin ndaj lehonave, me 10 raste. Këto të dhëna sugjerojnë se problematika kryesore e diskriminimit të konstatuar lidhet me statusin e lehonave, ndërsa format e tjera paraqiten në nivele më të kufizuara. Këto gjetje theksojnë rëndësinë e raportimit të çdo forme diskriminimi, ndërsa IQP-ja mbetet e përkushtuar në trajtimin në kohë dhe në mënyrë të barabartë të të gjitha rasteve të paraqitura, në funksion të mbrojtjes së të drejtave të punës dhe promovimit të barazisë në vendin e punës.



Lloji i shkeljeve	Numri i shkeljeve
Orari i punës	1 918
Pushime	782
Paga	2 092
Marrëdhëniet e punës	1 802
Tjera	17
Gjithsej	6 611

Tabela 27. Përmbledhje e shkeljeve të evidentuara në marrëdhëniet e punës

Të dhënat e paraqitura pasqyrojnë llojet kryesore të shkeljeve të evidentuara gjatë veprimtarisë inspektuese në fushën e marrëdhënieve të punës. Shkeljet më të shpeshta lidhen me pagën, duke reflektuar problematika të vazhdueshme në respektimin e të drejtave financiare të punëmarrësve. Pas tyre renditen shkeljet që kanë të bëjnë me orarin e punës dhe marrëdhënien e punës. Në tërësi, shpërndarja e këtyre të dhënave tregon se shfaqet kryesisht në elementet bazë të marrëdhënies së punës, duke kërkuar vëmendje të vazhdueshme institucionale për parandalim dhe trajtim të barabartë. Këto shkelje paraqiten si gjetje të veçanta brenda raporteve inspektuese, nga të cilat rrjedhin gjokat, vërejtjet apo masat e tjera administrative, pasi nga një raport inspektues mund të evidentohen disa shkelje njëkohësisht, ndërsa masa administrative shqiptohet si vendim i përmbledhur.

IQP-ja posedon mandatin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me dispozitën e nenit 12, sipas së cilës: “Çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një (1) person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtorë.” Punëdhënësi i cili nuk i përmbush detyrimet nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, obligohet që për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, të paguajë në Buxhetin e Kosovës kontribute mujore në lartësi të pagës minimale. Gjatë realizimit të inspektimeve të subjektet që posedojnë pesëdhjetë (50) ose më shumë punëtorë, është arritur që gjithsej të punësohen njëzet e pesë (25) punonjës me aftësi të kufizuara, si dhe të sigurohet zbatimi i obligimit për punëdhënësit që nuk kanë punësuar persona me aftësi të kufizuara, për të kryer pagesat mujore në lartësi të pagës minimale. Vlera totale e këtyre pagesave për vitin 2025 arrin në **654,582.40 €**.

Ndërsa, qëllimi i Ligjit Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve është mundësimi i sinjalizimit të shkeljeve në sektorin publik dhe privat, si dhe mbrojtja e sinjalizuesve. IQP-ja posedon mandatin e mbikëqyrjes së zbatimit të këtij Ligji në sektorin privat. Sipas ligjit të lartcekur, punëdhënësit privatë që kanë më shumë se pesëdhjetë (50) të punësuar janë të obliguar të caktojnë zyrtarin përgjegjës për sinjalizim. IQP-ja ka arritur të këshillojë dhe të sigurojë caktimin e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim në mbi njëqind e pesëdhjetë (150) subjekte ekonomike. Prej tyre, në pesëdhjetë (50) subjekte zyrtari përgjegjës është caktuar me kontratë pune, në përputhje me përshkrimin e detyrave të sinjalizimit, ndërsa në njëqind (100) subjekte të tjera punëdhënësit kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për sinjalizim si detyrë shtesë, përmes aktit administrativ – vendim.



9. Siguria dhe shëndeti në punë

Zbatimi i standardeve të sigurisë dhe shëndetit në punë, mbetet një prioritet kyç dhe një sfidë madhore për IQP-në. Gjatë vitit 2025, krahas veprimeve inspektuese, është kushtuar vëmendje e veçantë monitorimit të aksidenteve në vendin e punës, hetimit të shkaqeve të tyre dhe marrjes së masave parandaluese. Në këtë kapitull paraqiten statistikat dhe analizat lidhur me aksidentet në punë, situatën e sëmundjeve profesionale dhe masat e marra për përmirësimin e SSHP-së.

9.1. Aksidentet në punë

Më poshtë paraqiten rastet e aksidenteve në punë, përfshirë aksidentet fatale dhe jo fatale, të ndara sipas lëndimeve fatale dhe jo fatale. Të gjitha aksidentet e raportuara janë hetuar nga Inspektorati Qendror i Punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Prania e rasteve me pasoja fatale, evidenton nevojën për forcimin e mëtejshëm të masave parandaluese, rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes inspektuese dhe përmirësimin e zbatimit të detyrimeve ligjore nga subjektet ekonomike, veçanërisht në sektorët me risk të lartë. Në këtë kuadër, ndaj subjekteve përgjegjëse janë ndërmarrë masa administrative dhe ndëshkuese, në përputhje me Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe aktet nënligjore përkatëse.

Përkufizimi sipas legjislacionit në fuqi (*Përkufizimi sipas Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë*):

- 1.12. Aksident në punë ose për shkak të punës - çdo ngjarje të papritur gjatë procesit të punës, që shkakton dëmtimin të menjëhershëm trupor të të punësuarit/ve, dëmtim që sjell paaftësi të përkohshme, paaftësi të përhershme ose që sjell vdekje, si dhe çdo dëmtim tjetër të shëndetit që lidhet drejtpërdrejt me ushtrimin e veprimtarisë së punës.

Përkufizimi i përgjithshëm sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës (*përdoret si referencë plotësuese dhe sqaruese*):

- Aksidenti në punë: Një aksident në punë është një ndodhi e papritur dhe e paplanifikuar, përfshirë aktet e dhunës, që vijnë nga/ose në lidhje me punën që rezulton në një ose më shumë punëtorë që pësojnë një dëmtim personal, sëmundje ose vdekje. Aksidentet në punë ndahen në aksidente fatale dhe jo fatale.
- Lëndimi në punë: Një lëndim në punë është çdo lëndim personal, sëmundje ose vdekje nga aksidenti në punë. Po ashtu, lëndimet në punë ndahen në fatale dhe jo fatale.

Në vazhdim paraqitet një analizë e detajuar e faktorëve tregues që lidhen me aksidentet në punë, duke përfshirë shpërndarjen sipas muajve, regjioneve dhe degës së aktivitetit ekonomik, me qëllim orientimin e planifikimeve inspektuese dhe masave parandaluese në periudhat e ardhshme. Vërehet se numri i aksidenteve fatale nuk përkon plotësisht me numrin e lëndimeve fatale, pasi në një aksident fatal në punë janë evidentuar dy lëndime fatale, këta tregues paraqiten të ndarë në analizën në vijim. Ndërkaq, në rastin e aksidenteve jo fatale, numri i aksidenteve përkon me numrin e lëndimeve jo fatale.




Figura 22. Aksidentet në punë sipas muajve, 2025




Figura 23. Lëndimet në punë sipas muajve, 2025

Regjioni	Aksidentet në punë			Lëndimet në punë		
	Fatale	Jo fatale	Gjithsej	Fatale	Jo fatale	Gjithsej
Ferizaj	3	83	86	3	83	86
Gjakovë	1	71	72	2	71	73
Gjilan	2	44	46	2	44	46
Mitrovicë	1	39	40	1	39	40
Pejë	1	77	78	1	77	78
Prishtinë	5	176	181	5	176	181
Prizren	5	112	117	5	112	117
Gjithsej	18	602	620	19	602	621

Tabela 28. Aksidentet & Lëndimet në punë sipas regjioni të ndara në fatale dhe jo fatale

Të dhënat tregojnë se aksidentet jo fatale përbëjnë pjesën dërrmuese të rasteve në të gjitha rajonet, me numrin më të lartë në Prishtinë dhe Prizren. Aksidentet fatale mbeten shqetësuese, veçanërisht në Prishtinë dhe Prizren. Këto statistika nënvizojnë nevojën për vazhdimësi të masave parandaluese, rritje të ndërgjegjësimit dhe forcim të kontrolleve për të përmirësuar sigurinë dhe për të ulur rrezikun e aksidenteve në të gjitha rajonet.



Veprimtaria	Aksidentet në punë			Lëndimet në punë		
	Fatale	Jo fatale	Gjithsej	Fatale	Jo fatale	Gjithsej
Ndërtimtari	10	198	208	11	198	209
Prodhim	6	142	148	6	142	148
Shërbime	1	118	119	1	118	119
Arsim	-	7	7	-	7	7
Bujqësi	-	2	2	-	2	2
Energjetikë	1	40	41	1	40	41
Hotelier	-	21	21	-	21	21
Miniera sipërfaqësore	-	1	1	-	1	1
Shëndetësi	-	6	6	-	6	6
Tregti	-	46	46	-	46	46
Zejtari	-	2	2	-	2	2
Tjera	-	19	19	-	19	19
Gjithsej	18	602	620	19	602	621

Tabela 29. Aksidentet & Lëndimet në punë sipas veprimtarisë të ndara në fatale dhe jo fatale

Të dhënat sipas veprimtarisë tregojnë se aksidentet, si fatale ashtu edhe jo fatale, janë më të shprehura në veprimtaritë me risk të lartë, ku përfshihen punët fizike, përdorimi i makinerive dhe ekspozimi ndaj kushteve të rrezikshme të punës. Kjo situatë nënvizon rëndësinë e respektimit të masave të sigurisë, trajnimit të vazhdueshëm të punëtorëve dhe angazhimit të institucioneve dhe punëdhënësve për parandalimin e aksidenteve dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.




Figura 24. Shkalla e aksidenteve & lëndimeve (sipas ndarjes) fatale në numrin e përgjithshëm të aksidenteve & lëndimeve fatale të raportuara

(Aksidente & Lëndime fatale në punë të raportuara në një degë të caktuar të aktivitetit ekonomik ÷ Numri i përgjithshëm i aksidenteve & lëndimeve fatale të raportuara në punë) x 100.

Të dhënat tregojnë se aksidentet/lëndimeve fatale janë të përqendruara kryesisht në sektorin e ndërtimtarisë, pas saj vjen sektori i prodhimit, ndërsa shërbimet dhe energjetika numrin më të vogël të fataliteteve.




Figura 25. Shkalla e aksidenteve & lëndimeve (sipas ndarjes) jo fatale, në numrin e përgjithshëm të aksidenteve & lëndimeve jo fatale të raportuara

(Aksidente & Lëndime jo fatale në punë të raportuara në një degë të caktuar të aktivitetit ekonomik ÷ Numri i përgjithshëm i aksidenteve & lëndimeve jo fatale të raportuara në punë) x 100

Aksidentet jo fatale janë të barabarta me lëndimet jo fatale, për këtë arsye, ato janë paraqitur vetëm në një figurë.

Shpërndarja tregon se aksidentet jo fatale përqendrohen kryesisht në ndërtimtari me 33%, prodhimi me 23.59% dhe shërbimet me 19.6%. Këto tre veprimtari përbëjnë mbi 76% të të gjitha aksidenteve jo fatale të raportuara. Veprimtaritë e tjera kanë përqindje dukshëm më të ulëta.

Regjioni	Aksidentet në punë		Lëndimet në punë	
	Burra	Gra	Burra	Gra
Ferizaj	3	-	3	-
Gjakovë	1	-	2	-
Gjilan	2	-	2	-
Mitrovicë	1	-	1	-
Pejë	1	-	1	-
Prishtinë	5	-	5	-
Prizren	5	-	5	-
Gjithsej	18	-	19	-

Tabela 30. Aksidentet & Lëndimet me fatalitet sipas regjionit dhe gjinisë

Të dhënat tregojnë se aksidentet me fatalitet janë vetëm burra në të gjitha rajonet.



Fatale	Aksidentet në punë		Lëndimet në punë	
	Burra	Gra	Burra	Gra
Rastet	18	-	19	-
Pjesa (%)	100%	0%	100%	0%

(Lëndimet fatale të raportuara në punë që prekin gratë ÷ Numri i përgjithshëm i lëndimeve fatale të raportuara në punë) x 100.

Jo fatale	Burra	Gra
Rastet	536	66
Pjesa (%)	89%	11%

(Lëndimet jo fatale të raportuara në punë që prekin gratë ÷ Numri i përgjithshëm i lëndimeve jo fatale të raportuara në punë) x 100

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelë, pjesa e grave në rastet jo fatale të raportuara në punë, përbën 11% të totalit, me gjithsej 66 raste të regjistruara. Ndonëse kjo shifër është dukshëm më e ulët se ajo e burrave (të cilët përbëjnë 89% të rasteve), ajo tregon një prezencë më të lartë të grave në aksidentet jo fatale krahasuar me statistikat zero të rasteve fatale.




Figura 26. Aksidentet & Lëndimet në punë, jo fatale sipas regjionit dhe gjinisë




Figura 27. Aksidentet & lëndimet në punë me pasoja fatale ndër vite

Të dhënat mbi aksidentet dhe lëndimet fatale ndër vite tregojnë një trend rënës nga viti 2022 deri në vitin 2024, ku numri i rasteve ka zbritur nga 15 në 7, duke reflektuar një përmirësim të përgjithshëm në masat parandaluese dhe sigurinë në punë. Megjithatë, viti 2025 shënon një rritje të ndjeshme të rasteve fatale, çka përbën një sinjal shqetësues dhe tregon nevojën për analiza më të thelluara mbi shkaqet e kësaj rritjeje. Kjo situatë nënvizon rëndësinë e forcimit të kontrolleve, rritjes së ndërgjegjësimit dhe zbatimit rigoroz të standardeve të sigurisë për të parandaluar humbjen e jetëve në vendin e punës.



9.2. Shkeljet dhe parregullsitë e evidentuar gjatë vizitave inspektuese

Gjatë vizitave inspektuese të realizuara, janë evidentuar shkelje dhe parregullsi që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (SSHP). Këto shkelje përfshijnë kryesisht mungesën ose mosrealizimin e trajnimeve të detyrueshme për punëtorët, mungesën e angazhimit të ekspertëve të sigurisë dhe shëndetit në punë nga ana e punëdhënësve, mangësi në hartimin dhe zbatimin e planeve emergjente, mungesë ose papërshtatshmëri të vlerësimit të riskut, përdorimin jo adekuat të Pajisjeve Personale Mbrojtëse (PPM), mangësi në sigurimin e ndihmës së parë, si dhe parregullsi në vendosjen dhe mirëmbajtjen e shenjave të sigurisë në vendet e punës.

Në mënyrë të ngjashme me shkeljet e evidentuara në fushën e marrëdhënieve të punës, numri i shkeljeve dhe parregullsive në SSHP nuk përkon drejtpërdrejt me numrin e gjobave apo vërejtjeve të shqiptuara. Gjatë një vizite inspektuese ose brenda një raporti të vetëm inspektimi, mund të identifikohen disa shkelje të ndryshme njëkohësisht, ndërkohë që masa administrative shqiptohet si vendim i përmbledhur për subjektin përkatës.

Regjioni	Vendosja e shenjave	Menaxhimi i emergjencave	Ndihma e parë	PPM	Mungesë trajnimesh
Gjithsej	4 387	2 716	1 999	1 811	5 469

Tabela 31. Shkeljet e evidentuara në SSHP

Të dhënat e përmbledhura në tabelë paraqesin shpërndarjen e parregullsive sipas kategorive kryesore të sigurisë dhe shëndetit në punë. Nga totali i shkeljeve të evidentuara, vërehet se mungesa e trajnimeve paraqet kategorinë më të shpeshtë të shkeljeve (5 469 raste), duke reflektuar nevojën për ndërhyrje të vazhdueshme parandaluese dhe rritje të kapaciteteve të punëdhënësve në këtë fushë. Pason shkeljet që lidhen me shenjëzimin e sigurisë (4 387 raste) dhe menaxhimin e emergjencave (2 716 raste), të cilat përbëjnë elemente thelbësore për parandalimin e rreziqeve dhe reagimin efektiv në situata emergjente.

Shkeljet e lidhura me ndihmën e parë (1 999 raste) dhe Pajisjet Personale Mbrojtëse (PPM) (1 811 raste), tregojnë mangësi në zbatimin e masave bazë mbrojtëse në vendin e punës. Këto gjetje theksojnë rëndësinë e forcimit të kontroleve parandaluese dhe të ndërgjegjësimit të punëdhënësve për përgjegjësitë e tyre ligjore në garantimin e kushteve minimale të sigurisë dhe shëndetit për punëtorët.

9.3. Vlerësimi i riskut

Dokumenti i vlerësimit të riskut përbën një kërkesë të vazhdueshme të Inspektoratit Qendror të Punës në kuadër të zbatimit të legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë, pasi është baza kryesore për identifikimin, parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve në vendin e punës.

Inspektorët e kërkojnë rregullisht dokumentin e vlerësimit të riskut dhe zbatimin e këtij dokumenti gjatë veprimeve inspektuese. Ndërsa në periudhën në vijim kjo temë do të jetë një nga objektivat kryesore të inspektorëve, me fokus të veçantë në kontrollimin e cilësisë së dokumenteve dhe mënyrës së përgatitjes së tyre nga ekspertë dhe kompani të licencuara.

Kompanitë dhe ekspertët e SSHP-së përbëjnë një hallkë kyçe ndërmjet Inspektoratit dhe punëdhënësve, duke luajtur një rol të rëndësishëm në ngritjen e standardeve të SSHP-së. Vetëm përmes bashkëpunimit të strukturuar me këta profesionistë dhe verifikimit të vazhdueshëm të punës së tyre, mund të rritet niveli i vlerësimit të riskut dhe të kontribuohet realisht në parandalimin e aksidenteve në punë, në përputhje me praktikën ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor në fuqi.



Regjioni	Shkeljet
Ferizaj	96
Gjakovë	44
Gjilan	21
Mitrovicë	12
Pejë	35
Prishtinë	196
Prizren	98
Gjithsej	502

Tabela 32. Shkeljet e evidentuara për dokumentin e vlerësim të riskut

Tabela e mësipërme paraqet një pasqyrë të parregullsive të evidentuara në shtatë (7) regjione kryesore, lidhur me mungesën e dokumentit të vlerësimit të riskut.

Regjioni	<50 të punësuar	50-250 të punësuar	>250 të punësuar
Ferizaj	18	1	-
Gjakovë	25	4	3
Gjilan	444	10	-
Mitrovicë	25	4	-
Pejë	3	1	-
Prishtinë	383	29	6
Prizren	172	3	-
Gjithsej	1 070	52	9

Tabela 33. Shkeljet e evidentuara në angazhimin e ekspertëve të SSHP-së nga punëdhënësit

Shkeljet në angazhimin e ekspertëve janë pothuajse tërësisht të përqendruara te ndërmarrjet e vogla (nën 50 punësuar), të cilat përbëjnë mbi 94% të totalit me 1 070 raste të evidentuara. Gjilani dhe Prishtina udhëheqin me numrin më të lartë të shkeljeve në këtë kategori, përkatësisht me 444 dhe 383 raste, ndërkohë që vërehet një rënie drastike e parregullsive te ndërmarrjet e mesme (52 raste) dhe ato të mëdha (vetëm 9 raste). Ky trend sugjeron se bizneset me numër më të madh të punonjësve kanë struktura më të konsoliduara dhe menaxhim më profesional të ekspertëve në krahasim me subjektet më të vogla.

9.4. Manualët dhe listat e kontrollit për fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë

Inspektorati Qendror i Punës ka vënë në dispozicion lista kontrolluese për fusha të ndryshme të punës dhe të sigurisë dhe shëndetit në punë, të publikuara në ueb-faqen zyrtare të Inspektorati Qendror i Punës ([Listat Kontrolluese për Punëdhënësit](#)). Listat e njëjta IQP-ja i ka të zhvilluar për nevojat e inspektimeve dhe të njëjtat i përdorin gjatë inspektimeve (listat kontrolluese janë të integruara në Sistemin Elektronik për Inspektime).

Po ashtu, në ueb-faqen e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), në seksionin “Puna”, janë publikuar manuale, udhëzues dhe lista të tjera kontrolluese, të zhvilluara nga Divizioni përkatës për Marrëdhëniet në Punë (MP) dhe Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (SSHP), duke krijuar një bazë të gjerë udhëzuese për punëdhënësit dhe punëmarrësit. Këto materiale, të hartuara në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi, për Marrëdhënien e Punës dhe SSHP, përfshijnë gjithashtu infografikë, udhëzime praktike dhe mjete mbështetëse për vlerësimin e riskut, të cilat shërbejnë si ndihmë konkrete për punëdhënësit në identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve në vendin e punës.



Materialet janë të qasshme për të gjithë dhe synojnë të mbështesin vetëvlerësimin dhe përmirësimin e pajtueshmërisë ligjore.

9.5. Sëmundjet profesionale

Evidentimi i sëmundjeve profesionale në Kosovë, vazhdon të jetë një sfidë e madhe. Gjatë vitit 2025, nuk u raportua asnjë rast i ri i sëmundjes profesionale nga punëdhënësit apo institucionet shëndetësore. Kjo nuk do të thotë se sëmundje të tilla nuk ekzistojnë, përkundrazi, gjasat janë që raste të problemeve shëndetësore të lidhura me punën por ndodhin pa u identifikuar dhe raportuar si të tilla. Aktualisht, mungon një sistem efektiv i diagnostikimit dhe raportimit të sëmundjeve profesionale.

Rekomandohet krijimi i një komisioni të përbashkët me Ministrinë e Shëndetësisë, me të gjithë aktorët e fushës dhe ministritë përkatëse, për të rishikuar listën zyrtare të sëmundjeve profesionale të njohura dhe për të vendosur një mekanizëm raportimi. Plotësimi i këtij boshllëku kërkon bashkërendim midis Inspektoratit, sistemit shëndetësor dhe punëdhënësve. Në drejtim të politikave afatgjata, Inspektorati mbështet iniciativën për të krijuar një regjistër kombëtar të sëmundjeve profesionale. Në ndërkohë, inspektorët gjatë vizitave rutinë kontrollojnë nëse punëdhënësi ka regjistruar punëtorët për kontrolle të rregullta shëndetësore, sipas kërkesave të Ligjit në fuqi për SSHP-në.

Regjioni	Numri
Ferizaj	86
Gjakovë	555
Gjilan	2 599
Mitrovicë	-
Pejë	225
Prishtinë	1 086
Prizren	899
Gjithsej	5 450

Tabela 34. Shkeljet e evidentuara në kontrollet mjekësore të papërfunduar

Në total janë regjistruar 5 450 shkelje, me një përqendrim të theksuar në regjionin e Gjilanit, i cili paraqet numrin më të lartë të rasteve.

10. Grevat

Sipas konfirmimit zyrtar nga divizioni përkatës në kuadër të MFPT-së, gjatë periudhës përkatëse nuk ka pasur asnjë adresim apo njoftim zyrtar lidhur me lajmërimin e fillimit të grevave, ashtu siç parashihet dhe kërkohet shprehimisht nga dispozitat e Ligjit në fuqi për Grevat. Si rrjedhojë, institucioni nuk ka qenë i informuar në mënyrë formale për inicimin e ndonjë veprimi grevist brenda afateve dhe procedurave të përcaktuara nga legjislacioni përkatës. Në këtë kontekst, vlen të theksohet se niveli i organizimit sindikal në Kosovë mbetet relativisht i ulët, me një densitet të vlerësuar rreth 9.3%.¹⁷

Ndërsa, gjatë vitit 2025, Inspektorati Qendror i Punë (IQP) ka pranuar njoftime për dy raste të grevave të realizuara, të cilat janë trajtuar në përputhje me kompetencat e IQP-së dhe legjislacionin në fuqi. Secili rast është shqyrtuar në kuadër të procedurave përkatëse inspektuese, duke u bazuar në dokumentacionin e disponueshëm dhe në vlerësimin e përmbushjes së kërkesave ligjore për ushtrimin e së drejtës për grevë.

¹⁷ Divizioni për Politikat e Marrëdhënieve në Punë dhe Dialogut Social, si dhe Divizioni për Politikat e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, MFPT.



11. Aktivitetet e ndryshme

Gjatë periudhës raportuese dhe viteve të kaluara, Inspektorati Qendror i Punës ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi të formalizuara ndërinstytucionale, të cilat kanë shërbyer si bazë ligjore dhe operative për koordinimin e aktiviteteve inspektuese, zhvillimin e inspektimeve të përbashkëta dhe forcimin e zbatimit të legjislacionit të punës, si dhe të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Bashkëpunimet e realizuara, përfshijnë:

- Komunën e Skenderajt: marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e inspektimeve të përbashkëta;
- Komunën e Mitrovicës: marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e inspektimeve të përbashkëta;
- Administratën Tatimore të Kosovës (ATK): marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbim të informatave dhe realizimin e inspektimeve të përbashkëta, veçanërisht në adresimin e punës së padeklaruar dhe respektimin e obligimeve ligjore nga punëdhënësit (2024);
- Policia e Kosovës: marrëveshje bashkëpunimi për koordinimin e veprimeve inspektuese (2024);
- Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës, Gjakovë: marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e kontrolleve mjekësore periodike të stafit të Inspektoratit Qendror të Punës, në përputhje me kërkesat ligjore për siguri dhe shëndet në punë (2024);
- Kallxo.com: marrëveshje dhe forma bashkëpunimi me qëllim të rritjes së transparencës institucionale, informimin e publikut dhe ndërgjegjësimin për të drejtat dhe obligimet që burojnë nga legjislacioni i punës.

Aktivitetet e përbashkëta të zhvilluara gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, Inspektorati Qendror i Punës (IQP), zhvilloi një sërë aktiviteteve dhe aksionesh të koordinuara me partnerë institucionale, ndërkombëtarë dhe shoqërinë civile, duke përfshirë forume, punëtori, fushata sensibilizuese dhe inspektime të drejtpërdrejta në terren. Aktivitetet mbuluan temat e migracionit, digjitalizimin e inspektimeve, sigurinë dhe shëndetin në punë, respektimin e të drejtave të punëtorëve vendorë dhe të huaj, parandalimin e trafikut me njerëz dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe rajonal, duke përfshirë partnerët si ILO, GIZ, IKS, QPA dhe inspektoratet e vendeve fqinje. Përmes këtyre aktiviteteve, IQP-ja avancoi kapacitetet profesionale të inspektorëve, promovoi praktika të sigurta dhe të drejta pune, si dhe theksoi rëndësinë e llogaridhënies institucionale dhe transparencës në mbrojtjen e punëmarrësve.

Më poshtë janë paraqitur aktivitete të ndryshme të ndara sipas partnerëve dhe seksioneve të tjera

Rritja e Transparencës dhe Komunikimit me Publikun

Gjatë vitit raportues është shënuar progres i dukshëm në rritjen e transparencës institucionale dhe komunikimit me publikun dhe mediat. Aktivitetet kryesore përfshijnë: përgjigje të rregullta dhe në kohë ndaj pyetjeve të gazetarëve përmes e-mailit zyrtar dhe komunikimit aktiv me publikun përmes rrjeteve sociale, veçanërisht Facebook-ut. Po ashtu, ka filluar procesi për krijimin e ueb-faqes zyrtare të Inspektoratit Qendror të Punës, e cila do të jetë e licencuar nga ASHI-ja, me qëllim që të informohen qytetarët dhe të rritet qasja në shërbimet dhe informacionet institucionale.

Kallxo.com dhe mediat e tjera

Bashkëpunimi me Kallxo.com dhe media të tjera, ka kontribuar në rritjen e llogaridhënies publike dhe parandalimin e shkeljeve përmes ekspozimit publik të praktikave të paligjshme. Në kuadër të aksioneve të përbashkëta ndërinsticionale, IQP-ja ka komunikuar publikisht edhe masat administrative të ndërmarra, përfshirë ndalimin e përkohshëm të aktiviteteve të subjekteve që nuk kanë përmbushur kërkesat ligjore, duke forcuar rolin e tij në mbrojtjen e sigurisë, dinjitetit dhe të drejtat e punëtorëve. Në kuadër të raportimit mediatik me Kallxo.com, u pasqyruan aksionet e IQP-së në ndërtimtari, ku inspektorët identifikuan rreziqet e menjëhershme dhe kërkuar korrigjimin e tyre, duke theksuar se pa masa dhe pa riinspektim, nuk lejohet rikthimi i punëtorëve në punë.

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

Gjatë vitit 2025, Inspektorati Qendror i Punës i Republikës së Kosovës mori pjesë në aktivitete dhe iniciativa rajonale dhe ndërkombëtare, duke përfshirë prezantimin e Raporteve të Performancës së Ballkanit Perëndimor mbi Shtyllën Evropiane të të Drejtave Sociale (EPSR) në Tiranë, Punëtorinë Rajonale PSIMM në Vjenë dhe nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimi me Inspektoratin Shtetëror të Punës të Shqipërisë. Këto aktivitete synuan forcimin e bashkëpunimit ndërinsticionale dhe rajonal, harmonizimin e praktikave të inspektimit, ngritjen e kapaciteteve profesionale të inspektorëve dhe promovimin e mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve, duke përfshirë parandalimin e migrimit të parregullt dhe zhvillimin e mekanizmave të koordinuar për inspektime të përbashkëta dhe shkëmbim informacioni.



Ditët e Kapitalit Njerëzor të Ballkanit Perëndimor – Prezantimi EPSR



Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO)

IQP-ja, me mbështetjen e ILO-s dhe financimin e Qeverisë Suedeze, ka zbatuar aktivitete në kuadër të projektit “Efikasiteti i Inspektoratit të Punës”, të fokusuar në forcimin e kapaciteteve institucionale, digjitalizimin e inspektimeve, përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi të drejtat e punës. Aktivitetet përfshijnë konferenca, trajnime profesionale, fushata ndërgjegjëse në nivel kombëtar, lansimin e Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Rasteve (SEMR) dhe iniciativa të bashkëpunimit me media.

Muaji	Aktiviteti	Titulli	Zbatuesi	Nr. i pjesëmarrësve
Prill	Konferencë	Dita Botërore e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë & lansimi i projektit “Efikasiteti i Inspektoratit të Punës”	ILO/IQP	>80
Korrik	Punëtori / Trajnim	Trajnime të trajnerëve seniorë për inspektorë të punës	ILO/IQP	12
Gusht	Fushatë ndërgjegjëse	Fushatë për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në nivel kombëtar	ILO/IQP	3 205 punëtorë 251 punishte
Tetor	Lansim sistemi	Lansimi i Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Rasteve (SEMR)	ILO/IQP	60
Tetor	Punëtori	Punëtori për të drejtat e punës, migrimin dhe SSHP (media & inspektorë)	ILO/IPK/AGK/ GIZ-EG	30
Nëntor	Trajnim	Investigimi i aksidenteve në vendin e punës	ILO/IQP	18
Dhjetor	Çmimi i gazetarit të vitit	Për raportim mbi të drejtat e punës	ILO/AGK	Pjesëmarrës të ndryshëm

Përmbledhje e aktiviteteve kryesore gjatë vitit 2025:

- 28 prill 2025 - Konferenca për Ditën Botërore të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë: U organizua konferencë për shënimin e Ditës Botërore të SSHP-së dhe lansimin e projektit “Efikasiteti i Inspektoratit të Punës”, me fokus në forcimin e rolit të Inspektoratit të Punës, digjitalizimin e proceseve inspektuese dhe dialogun ndërinstitucional.
- 1–3 korrik 2025 - Punëtori për trajnimin e trajnerëve seniorë: U zhvillua punëtori treditore për 12 inspektorë të punës, me qëllim të forcimit të kapaciteteve të brendshme dhe përgatitjen e tyre për trajnimin e inspektorëve të rinj.
- 13–29 gusht 2025 - Fushatë ndërgjegjëse për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë: U realizua fushatë ndërgjegjëse në të gjitha rajonet e Kosovës, gjatë së cilës u vizituan 251 kantiere ndërtimi dhe u zhvilluan biseda direkte me 3 205 punëtorë për promovimin e praktikave parandaluese.
- 15 tetor 2025 - Lansimi i Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Rasteve (SEMR): U lansua SEMR, duke shënuar një hap të rëndësishëm në digjitalizimin e inspektimeve, përfshirë pajisjen e inspektorëve me pajisje portabile dhe demonstrimin praktik të sistemit.
- 17–18 tetor 2025 - Punëtori mbi të drejtat e punës dhe rolin e mediave: U organizua punëtori dyditore me gazetarë dhe inspektorë të punës, me fokus në të drejtat e punës, migrimin, sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe prezantimin e Çmimit Vjetor për Raportim mbi të Drejtat e Punës.
- 25–27 nëntor 2025 - Trajnim për investigimin e aksidenteve dhe vdekjeve në punë: U zhvillua trajnim treditore për 18 inspektorë mbi hetimin e aksidenteve dhe vdekjeve në vendin e punës, me fokus në teknikat e hetimit dhe analizën e riskut.
- 10 dhjetor 2025 - Çmimi i gazetarit të vitit për raportim mbi të drejtat e punës. Ky çmim u dorëzua ceremonialisht nga Shkëlqesia e Tij, Ambasadori Suedezi Westerlund, në një ceremoni ku u vlerësua kontributi i gazetarit në promovimin e të drejtave të punës dhe ndërgjegjësimin publik.



Lansimi i Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Rasteve (SEMR)



Trajnim për investigimin e aksidenteve në vendin e punës



PRISHTINË 20 AUGUST 2025



PRIZREN 19 AUGUST 2025



FERIZAJ 13 AUGUST 2025



GJAKOVË 22 AUGUST 2025



PEJË 22 AUGUST 2025



GJILAN 14 AUGUST 2025



MITROVICË 18 AUGUST 2025



Fushatë ndërgjegjësuere për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në nivel kombëtar



Punëtori për të drejtat e punës, migrimin dhe SSHP-në (media & inspektorë)

GIZ Kosova

IQP-ja me mbështetjen e GIZ-it, në kuadër të projektit *“Fuqizimi i Qeverisjes së Migracionit dhe Kapaciteteve të Shoqërisë Civile në Kosovë”*, mori pjesë në aktivitete të fokusuara në mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për punësimin e punëtorëve migrantë dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rajonal. Po ashtu, siç është cekur më lartë, Kosova dhe Shqipëria kanë nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet inspektorateve të punës, e përkrahur nga GIZ-i, e cila synon zhvillimin e inspektimeve të përbashkëta ose të koordinuara, shkëmbimin e informacionit përmes protokolleve ndërinstitucionale, nisma ndërgjegjësuere për punëdhënësit dhe punëmarrësit, si dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të inspektorëve në të dyja vendet. Këto aktivitete kontribuan në përmirësimin e praktikave inspektuese, identifikimin e sfidave në zbatimin e legjislacionit të punës dhe avancimin e udhëzuesve praktikë, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Muaji	Aktiviteti/ Titulli	Zbatuesi	Nr. i pjesëmarrësve
Prill	Trajnim/ Roli i inspektorëve të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në fushën e punësimit të punëtorëve migrantë në Kosovë (Grupi 1)	ECMI Kosovo	22
Qershor	Trajnim/ Roli i inspektorëve të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në fushën e punësimit të punëtorëve migrantë në Kosovë (Grupi 2)	ECMI Kosovo	16
Shtator	Punëtori/ Rishikimi i Draftit të Udhëzuesit për Punëtorët e Huaj	ECMI Kosovo	Ndërinstitucional
Nëntor	Punëtori/ Shqyrtimi i Draftit të Doracakut për Punëtorët e Huaj	ECMI Kosovo	Ndërinstitucional



Kosova dhe Shqipëria kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit për inspektoratet e punës



Trajnimet e realizuara – Roli i inspektorëve të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në fushën e punësimit të punëtorëve migrantë në Kosovë



Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS)

IQP-ja në bashkëpunim me IKS-në, realizoi aktivitete të përbashkëta që përfshijnë një punëtorë dhe monitorime të përbashkëta në terren, me fokus kryesor në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë dhe vendorë. Në kuadër të Javës Evropiane për Siguri dhe Shëndet në Punë, IQP-ja mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”, me temë “Digjitalizimi dhe Organizimi i Përgjithshëm i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë”, e realizuar në bashkëpunim me IKS-në, ku u diskutuan praktikat dhe sfidat e avancimit të sigurisë dhe shëndetit në punë në epokën digjitale. Këto aktivitete kontribuan në forcimin e kapaciteteve inspektuese, përmirësimin e praktikave të mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit të punës, rritjen e vetëdijes së punëtorëve dhe thellimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Përmbledhje e aktiviteteve kryesore gjatë vitit:

1. Punëtorë për inspektimin e punëtorëve migrantë dhe lokalë

17–18 prill 2025: Gjatë vitit 2025, Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), në bashkëpunim të ngushtë me Inspektoratin Qendror të Punës, ka zhvilluar aktivitete të përbashkëta me qëllim që të forcohen kapacitetet inspektuese dhe të përmirësohet mbrojtja e të drejtave të punëtorëve migrantë dhe lokalë në Kosovë. Në këtë kuadër, më 17–18 prill 2025 u organizua një punëtorë dyditore e fokusuar në praktikat e inspektimit të punëtorëve migrantë dhe vendorë. Punëtorë kishte për qëllim adresimin e sfidave konkrete me të cilat përballen inspektorët e punës në terren, veçanërisht në rastet që lidhen me punësimin e punëtorëve migrantë, sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe respektimin e legjislacionit të punës. Gjatë punëtorisë u zhvilluan diskutime të detajuara mbi:

- Përvojat praktike të Inspektoratit të Punës në inspektimin e punëtorëve migrantë;
- Rastet e fundit të aksidenteve në punë dhe mësimet e nxjerra nga këto raste;
- Të dhënat dhe trendet lidhur me shkeljet më të shpeshta të identifikuara gjatë inspektimeve;
- Nevojën për qasje të harmonizuara dhe të ndjeshme ndaj rasteve që përfshijnë punëtorë migrantë.

Në kuadër të punëtorisë u prezantua edhe Manuali “Udhëzues i shkurtër për të drejtat e punëtorëve migrantë në Kosovë”, i cili synon të shërbejë si mjet praktik mbështetës për inspektorët e punës, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre në terren.

2. Monitorim i përbashkët në terren për punëtorët migrantë

IKS-ja në koordinim me Inspektoratin Qendror të Punës, ka marrë pjesë në aktivitete të monitorimit në terren, me fokus në kushtet e punës së punëtorëve migrantë në Kosovë. Këto aktivitete kanë pasur për qëllim:

- Vlerësimin e zbatimit praktik të legjislacionit të punës në vendet e punës;
- Identifikimin e shkeljeve potenciale të të drejtave të punëtorëve;
- Informimin e drejtpërdrejtë të punëtorëve migrantë mbi të drejtat e tyre dhe mekanizmat ligjorë të mbrojtjes.

Gjatë monitorimeve, përfaqësuesit e IKS-së dhe inspektorët e punës, kanë ofruar sqarime praktike dhe informuese për punëtorët, duke kontribuar në rritjen e vetëdijes së tyre dhe në parandalimin e shkeljeve të mëtejme.

3. Vazhdimësia e bashkëpunimit institucional

Aktivitetet e vitit 2025 përfaqësojnë vazhdimësinë e bashkëpunimit të vendosur ndërmjet IKS-së dhe Inspektoratit Qendror të Punës gjatë vitit 2024, përfshirë edhe punëtorinë e organizuar më 16–17 tetor 2024 për implementimin e Rregullores (ZKM) Nr. 10/2024 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Ekzekutive të Inspektoratit Qendror të Punës. Kjo vazhdimësi ka kontribuar në ndërtimin e një partneriteti të qëndrueshëm dhe në përmirësimin gradual të qasjeve institucionale ndaj



mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit të punës, veçanërisht në kontekstin e punësimit të punëtorëve migrantë.



Foto nga aktivitete të ndryshme, si dhe Java Evropiane për Siguri dhe Shëndet në Punë (Tetor 2025)

Qendra për Politika dhe Avokim (QPA)

IQP-ja bashkëpunoi me QPA-në në kuadër të projektit “Përtej Punësimit”, të financuar nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë, duke zhvilluar trajnime të specializuara për 33 inspektorë (10 gra dhe 23 Burra), diskutime me nxënës të Qendrave të Kompetencës dhe ndërveprime me punëtorë në sektorë me rrezik të lartë. Aktivitetet përqendroheshin në forcimin e kapaciteteve institucionale, promovimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e punës.

Përmbledhje e aktiviteteve kryesore gjatë vitit:

Të gjitha aktivitetet e QPA-së të përshkruara në këtë raport, janë realizuar në kuadër të projektit “Përtej Punësimit”, i zbatuar nga Qendra për Politika dhe Avokim përmes “HumanRightivism”, me mbështetje të “Community Development Fund” dhe financim nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë. Projekti është konceptuar si një program që synon të adresojë çështjet e të drejtave të punës përmes tri niveleve të ndërhyrjes: forcimit të kapaciteteve institucionale të Inspektoratit Qendror të Punës, informimit dhe përgatitjes së të rinjve që hyjnë në tregun e punës, si dhe ndërveprimit të drejtpërdrejtë me punëtorët në sektorin privat. Të gjitha aktivitetet janë zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me Inspektoratin Qendror të Punës dhe janë ndërtuar mbi një qasje praktike, të orientuar drejt situatave reale që hasen në terren.



Trajnime për Inspektoratin Qendror të Punës mbi diskriminimin, diversitetin dhe përfshirjen në vendin e punës

Gjatë periudhës nëntor–dhjetor 2025, inspektorët kanë marrë trajnime nga Qendra për Politika dhe Avokim, të përqendruara në identifikimin dhe trajtimin e diskriminimit në vendin e punës, si dhe në kuptimin praktik të koncepteve të diversitetit dhe përfshirjes. Trajnimet shërbyen edhe si hapësirë për diskutim institucional mbi rolin e Inspektoratit të Punës në promovimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Në këtë kuadër, u trajtua nevoja për një qasje më të sistematizuar ndaj rasteve të diskriminimit dhe për zhvillimin e praktikave të brendshme që mundësojnë trajtim më të njëtrajtshëm të këtyre rasteve në të gjitha rajonet e Kosovës.



Diskutime informuese me nxënës të Qendrave të Kompetencës

Gjatë muajit tetor 2025, janë realizuar gjashtë (6) diskutime me nxënës të Qendrave të Kompetencës në pesë (5) rajone të Kosovës. Këto aktivitete ishin të orientuara drejt nxënësve të vitit të fundit, të cilët ndodhen në fazën e përgatitjes për hyrjen në tregun e punës, të cilët përballen për herë të parë me marrëdhënie formale të punësimit.



QPA-ja realizoi gjithsej dhjetë diskutime me punëtorë të sektorit privat në kompani të ndryshme, kryesisht në sektorët e prodhimit dhe ndërtimtarisë.

Gjatë vitit, janë realizuar dhjetë (10) diskutime me punëtorë të sektorit privat në kompani të ndryshme në mbarë Kosovën, kryesisht në sektorët e prodhimit dhe ndërtimtarisë. Këto sektorë u përzgjedhën për shkak të natyrës së punës dhe rreziqeve të shtuara që lidhen me kushtet e punës dhe sigurinë në vendin e punës. Diskutimet u zhvilluan në prani të inspektorëve të punës, u fokusuan në përvojat e drejtpërdrejta të punëtorëve në vendin e punës. Temat kryesore, përfshinë: kontratat e punës, orarin e punës, pushimet vjetore dhe mjekësore, të drejtat e lehonisë, punën gjatë festave dhe mënyrat se si punëtorët mund të reagojnë kur përballen me shkelje të të drejtave të tyre. Një pjesë e veçantë e diskutimeve iu kushtua sigurisë dhe shëndetit në punë. U trajtua përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale, si: helmetat, maskat dhe syzat mbrojtëse, si dhe rreziqet që lindin nga mungesa ose përdorimi i pamjaftueshëm i tyre. Punëtorët ndanë përvoja konkrete lidhur me kushtet fizike të punës dhe me situatat ku siguria nuk trajtohet si prioritet. Në këto diskutime, Inspektorati i Punës u prezantua si institucion ku punëtorët mund të drejtohen jo vetëm për inspektim formal, por edhe për këshillim dhe informim. U sqarua se si mund të bëhen ankesat, cilat janë procedurat dhe si trajtohen rastet pas paraqitjes së një shqetësimi. Kjo qasje synoi të krijojë një kuptim më të qartë të rolit të Inspektoratit si pikë referimi për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Aktivitetet në kuadër të bashkëpunimit me projektin “HumanRightivism/CDF”

Gjatë vitit 2025, CDF-ja përmes projektit “Human Rightivism” dhe në bashkëpunim të ngushtë me Inspektoratin Qendror të Punës (IQP) dhe Qendrën për Politika dhe Avokim (QPA), ofroi mbështetje të strukturuar për forcimin e kapaciteteve institucionale, përmirësimin e proceseve të raportimit dhe avancimin e praktikave të inspektimit, me fokus të veçantë në çështjet e diskriminimit, shfrytëzimit dhe ngacmimit në vendin e punës.

Përmbledhje e aktiviteteve kryesore gjatë vitit:

- Dy punëtori (22–23 janar 2025) për raportimin vjetor dhe standardizimin e formës së raportimit;
- Kompletimi i Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Ekzekutive të Inspektoratit Qendror të Punës;
- Realizimi i raporti njëvjeçar të monitorimit, i cili evidentoi përparim në përputhshmëri procedurale dhe praktikat e inspektimit;
- Monitorimi i 12 inspektimeve me qëllim që të krijohet një bazë e të dhënave dhe e vlerësimit të terrenit për ndërhyrje të ardhshme;
- Diskutime të hapura në kompani (në sektorë me risk të lartë si prodhimi dhe ndërtimtaria) ku QPA-ja dhe Inspektorati zhvilluan dialog me punëmarrësit në ambientet e punës;
- Realizimi i një ankete Omnibus me 1 065 të anketuar për matjen e perceptimit publik mbi diskriminimin në vendin e punës (në bashkëpunim me IQP-në dhe QPA-në);
- IQP-ja me mbështetjen e CDF-së, organizoi një punëtori treditore me drejtorët e departamenteve dhe udhëheqësit e divizioneve për vlerësimin e Planit të Performancës për periudhën janar–qershor 2025;
- Inspektorati me mbështetjen e CDF-së, hartoi draftin e parë të dokumentit metodologjik të brendshëm, si udhëzues për matjen objektive të cilësisë së inspektimeve.



Agjencia për Barazi Gjinore/ Zyra e Kryeministrit

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore, në të cilën IQP-ja ka marrë pjesë në panele diskutimi, organizoi takimin konsultativ të nivelit të lartë mbi “*Sigurinë e grave në vendin e punës*”. Aktiviteti shërbeu si platformë dialogu për institucionet, ekspertët dhe shoqërinë civile, duke adresuar diskriminimin gjinor, pasigurinë dhe mirëqenien e grave dhe duke kontribuar në avancimin e Ligjit të ri të Punës dhe të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2025–2035.



Takimi i organizuar për të nëntin vit me radhë “Siguria e grave në vendin e punës”.



Aktivitete të ndryshme



Forumi i Partneritetit Shumëpalësh për Migracionin (SEM): IQP-ja mori pjesë në Forumin për Migracionin ku u diskutuan narrativat e migracionit të bazuara në dëshmi, sistemet e integritetit dhe nevojat e tregut të punës, përfshirë gjetjet e para nga një anketë për perceptimet ndaj migrantëve.



Pjesëmarrja në “Java e Integritetit” (APK/Forumi Konsultativ)

IQP-ja mori pjesë si paneliste në “Javën e Integritetit” duke adresuar luftën kundër korrupsionit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në vendin e punës. U theksua roli i Inspektoratit në garantimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes nga hakmarrja për punëmarrësit që raportojnë shkelje.




Takime me partnerët sindikalë

U zhvilluan takime me përfaqësues të sindikatave (Federata e Sindikatave të Shëndetësisë, Sindikata e Doganave, si dhe Sindikata e “Postës”) për të forcuar bashkëpunimin në avancimin e kushteve të punës, mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe kulturën e sigurisë në punë.



Njoftimet publike në mjetet e komunikimit

Gjatë vitit 2025, IQP-ja publikoi njoftime zyrtare për opinionin publik, lidhur me raste të identifikuar gjatë inspektimeve dhe monitorimeve, përfshirë mbyllje të përkohshme të veprimtarisë pas ankesave anonime në sektorin e shitjes, ndalim të punimeve pas raportimeve mediatike dhe verifikimeve në terren për mungesë të masave të detyrueshme të SSHP-së, si dhe ndalim të menjëhershëm të përdorimit të ashensorit në institucion shëndetësor pas ankesës zyrtare, deri në zbatimin e masave korrigjuese. Përmes këtyre njoftimeve u theksua zbatimi i ligjit, vendosja e masave parandaluese dhe mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve dhe qytetarëve



Procesi i hartimit të Planit të Performancës 2026 (me mbështetje GIZ).

IQP-ja ka hartuar Planin e Performancës 2026, i cili përcakton objektivat, iniciativat dhe treguesit për promovimin e punës së denjë, mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve dhe rritjen e respektimit të ligjit.

Takim pune me GIZ-in: Reforma inspektuese / ZIP

U zhvillua takim me përfaqësuesen e GIZ-it, ku u diskutuan arritjet në inspektimet e bazuara në risk, forcimi i bashkëpunimit institucional, ulja e barrës administrative dhe rifreskimi i listave të kontrollit. U riafirmua përkushtimi për avancimin e praktikave inspektuese.





Takim me përfaqësuesin e GIZ-it për Kosovën:
IQP-ja zhvilloi takim me përfaqësues të GIZ-it ku u diskutua mbështetja për forcimin institucional dhe bashkëpunimi në proceset reformuese. U shpreh mirënjohje për përkrahjen e vazhdueshme dhe u riafirmua angazhimi për përmirësim të kushteve dhe zbatim të ligjit.



Fushatë sensibilizuese në ndërtimtari me motivacionin “Çdo punëtor të kthehet i sigurt”

IQP-ja zhvilloi fushatë në shtatë (7) rajone, me bashkëbisedime direkte me mbi 3 000 punëtorë dhe shpërndarje materiale udhëzuese mbi punën në çati, gërmime, skela dhe PPM.



Forcimi i Bashkëpunimit Rajonal për Punëtorët Migrantë

Inspektoratet e Punës së Kosovës dhe Shqipërisë kanë zhvilluar takim pune për të forcuar bashkëpunimin në fushën e migracionit të punës dhe mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve migrantë.



12. Përfundime dhe rekomandime

12.1. Përfundimet

Mund të konstatohet se Inspektorati Qendror i Punës, ka shënuar progres të dukshëm drejt modernizimit institucional, duke përmbushur njërën ndër objektivat kryesore. Megjithatë, ky progres shoqërohet ende me sfida strukturore që kërkojnë trajtim të menjëhershëm dhe të qëndrueshëm.

Gjatë vitit 2025, IQP-ja ka realizuar 10 812 veprime inspektuese, duke mbuluar sektorët e identifikuar si prioritarë në planifikimin fillestar. Megjithatë, ky nivel i inspektimeve nuk ka qenë i mjaftueshëm për parandalimin efektiv të aksidenteve në vendin e punës dhe për arritjen e objektivave afatgjata, për një mjedis pune të sigurt dhe të barabartë për të gjithë punëtorët.

Inicimi i transferimit nga një sistem kryesisht manual në sistemin digjital SEMR, vlerësohet si një nga arritjet kryesore të vitit 2025, duke përmirësuar ndjeshëm menaxhimin e rasteve, transparencën dhe efikasitetin operacional të inspektimeve.

Performanca e vitit 2025 është realizuar me një staf prej 54 inspektorësh, që përfaqëson një pjesë të strukturës së paraparë me Rregulloren (ZKM) Nr. 10/2024. Mbingarkesa administrative ka ndikuar drejtpërdrejt në kufizimin e kohës së dedikuar për inspektime teknike cilësore, veçanërisht në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Gjetjet nga terreni tregojnë se kultura e parandalimit mbetet në nivel të ulët. Rastet me lëndime të rënda dhe me fatalitet dëshmojnë se masat mbrojtëse shpesh trajtohen si formalitet dhe jo si domosdoshmëri jetike. Po ashtu, mungesa e raportimit të sëmundjeve profesionale, tregon mangësi serioze në diagnostikimin dhe monitorimin shëndetësor të punëtorëve.

Progresi në luftimin e informalitetit është ndikuar pozitivisht nga bashkëpunimi me Administratën Tatimore të Kosovës, i cili ka prodhuar rezultate konkrete në identifikimin e punëtorëve të paregjistruar dhe ka dëshmuar se integrimi i bazave të të dhënave rrit ndjeshëm efikasitetin e inspektimit.

Janë realizuar përparime në digjitalizim, përmirësim të infrastrukturës (pajisje me PPM) dhe transparencë institucionale, ndërsa mbeten për t'u adresuar çështjet që kërkojnë reforma ligjore dhe përforsim të burimeve njerëzore.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025 ka filluar procesi i digjitalizimit të Arkivit Qendror përmes sistemit SMAED, i cili paraqet një avancim të rëndësishëm në ruajtjen e dokumentacionit, sigurinë e të dhënave dhe qasjen institucionale në informacione.



12.2. Rekomandimet

Bazuar në analizën e performancës së vitit 2025 dhe në përputhje me Planin e Performancës 2026, do të ndërmerren hapat e mëposhtëm:

1. Konsolidimi i burimeve njerëzore dhe kapaciteteve teknike
 - Finalizimi i rekrutimit të inspektorëve të rinj për përmbushjen e strukturës së miratuar, me fokus në profile teknike për forcimin e inspektimeve në fushën e SSHP-së.
 - Implementimi i një sistemi të trajnimit të vazhdueshëm dhe certifikimit profesional, me theks në hetimin e aksidenteve dhe analizën e rreziqeve specifike.
2. Avancimi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (SSHP)
 - Forcimi i mëtejshëm i qasjes parandaluese përmes inspektimeve këshilluese dhe ofrimit të udhëzuesve praktikë për punëdhënësit.
 - Zhvillimi i një mekanizmi funksional për regjistrimin dhe monitorimin e sëmundjeve profesionale, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.
 - Zbatimi i politikës së tolerancës zero ndaj mosrespektimit të kushteve teknike dhe standardeve të SSHP-së në sektorët me risk të lartë.
3. Integrimi digjital dhe transparenca
 - Përfundimi i ndërlidhjes së sistemit SEMR me bazat e të dhënave të institucioneve relevante për shkëmbim automatik të informatave.
 - Vazhdimi i implementimit të plotë të sistemit SMAED për sigurimin e një arkivi digjital të qëndrueshëm dhe të qasshëm.
4. Reforma ligjore dhe strategjike
 - Rishikimi i fushëveprimit ligjor të IQP-së, me qëllim të përqendrimit në inspektimet thelbësore dhe transferimin e kompetencave jorelevante tek institucionet përkatëse.
 - Vazhdimi i bashkëpunimit ndërinstitutional, si dhe intensifikimi i programeve të vetëdijesimit dhe i masave për luftimin e punës së padeklaruar.



13. Referencat

- Ligji Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë;
- Ligjin Nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës 2002/9;
- Ligji Nr. 03/L-212 i Punës;
- Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë;
- Ligji Nr. 08/L-067 për Inspektimet;
- Rregullorja (ZKM) Nr. 10/2024 për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Ekzekutive të Inspektoratit Qendror të Punës;
- C081 Konventa mbi Inspektimin e Punës, 1947 (Nr. 81);
- C129 Konventa mbi Inspektimin e Punës (Bujqësi), 1969 (Nr. 129);
- ILO, Udhëzuesi për Harmonizimin e Statistikave të Inspektimit të Punës;
- Të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), për vitin raportues 2025.



14. Shtojca

14.1. Ligjet dhe rregulloret relevante për shërbimin e inspektimit

Legjislacioni që rregullon punën e shërbimit të inspektimit të punës, zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjitha industrinë, përfshirë edhe sektorin e bujqësisë, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Në vazhdim paraqitet një listë e legjislacionit kryesor që rregullon fushëveprimtarinë e Inspektoratit Qendror të Punës. Për të gjitha aktet e tjera nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet përkatëse, referojuni [Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës](#), ueb-faqes zyrtare të [Inspektoratit Qendror të Punës](#) dhe ueb-faqes së [Ministritë së Financave, Punës dhe Transfereve \(MFPT\)](#).

Akti ligjor (emërtimi zyrtar)	Link – Gazeta Zyrtare
Ligji Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë	https://gzk.rks-gov.net/actdetail.aspx?Actid=3252
Ligji Nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës 2002/9	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2581
Rregullorja (ZKM) Nr. 10/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Ekzekutive të Inspektoratit Qendror të Punës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=96850
Ligji Nr. 03/L-212 i Punës	https://gzk.rks-gov.net/actdetail.aspx?Actid=2735
Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë	https://gzk.rks-gov.net/actdetail.aspx?Actid=8689
Ligji Nr. 08/L-067 për Inspektimet	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=53067
Ligji Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit	https://gzk.rks-gov.net/actdetail.aspx?actid=8665
Ligji Nr. 03/L-200 për Greva	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2701
Ligji Nr. 04/L-119 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-200 për Grevat	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2845
Ligji Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2620
Ligji Nr. 05/L-078 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12811
Ligji Nr. 04/L-219 për të Huajt	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876#
Ligji Nr. 06/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16333
Ligji Nr. 04/L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2754
Ligji Nr. 05/L-023 për Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11228



Ligji Nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18303
Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924
Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559
Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923
Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8666
Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=81430
Ligji Nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2539
Ligji Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85181
Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2870
Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761
Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770
Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2543
Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2012 për përcaktimin e gjohave dhe shumave konkrete për shkelje të dispozitave të ligjit të punës	https://gzk.rks-gov.net/actdetail.aspx?actid=8160
Rregullorja (QRK) NR. 12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të performancës për agjencitë në kuadër të administratës shtetërore	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=73509
Rregullorja (MPMS) Nr. 01/2021 për kualifikimin e personave përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, licencimin e kompanive të shërbimeve dhe trajnimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=37745
Rregullorja (MPMS) Nr. 02/2021 për vlerësimin e riskut në vendin e punës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=37746
Rregullorja (MPMS) Nr. 01/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (MPMS) Nr. 04/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=32300
Rregullorja (MPMS) Nr. 02/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 05/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=32302
Rregullorja (MPMS) Nr. 01/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga rreziqet lidhur me dridhjen në vendin e punës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13417



Rregullorja (MPMS) Nr. 02/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet lidhur me zhurmën në vendin e punës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13418
Rregullorja (MPMS) Nr. 03/2017 për parandalimin e lëndimeve nga mjetet e mprehta në vendet e punës pranë Sektorit të Kujdesit Shëndetësor dhe Spitalor	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15652
Rregullorja (MPMS) Nr. 04/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet e lidhura me kancerogjenët dhe mutagjenët në punë	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15653
Rregullorja (MPMS) Nr. 05/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet e lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë në punë	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15700
Rregullorja (MPMS) Nr. 06/2017 për kriteret minimale të sigurisë dhe shëndetit në vend ndërtimet të përkohshme apo mobile	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15701
Rregullorja (MPMS) Nr. 07/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj azbestit në punë	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15702
Rregullorja (MPMS) Nr. 08/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet e lidhura me fushat elektromagnetike në vendin e punës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15793
Rregullorja (MPMS) Nr. 09/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet e lidhura me rrezatimin optik në vendin e punës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15794
Rregullorja (MPMS) Nr. 10/2017 për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve nga risqet e lidhura me agjentët kimikë në punë	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15795
Rregullorja (MPMS) Nr. 02/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13079
Rregullorja (MPMS) Nr. 03/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për mbrojtjen e të punësuarve lidhur me punën e krahut me ngarkesa	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13080
Rregullorja (MPMS) Nr. 04/2016 për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13081
Rregullorja (MPMS) Nr. 05/2016 për kërkesat minimale për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve në risk nga ambientet shpërthyes	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13232
Rregullorja (MPMS) Nr. 06/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13233